KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# 90 Vjet



Tiranë 2015

1925-2015

Seria: botime KLSH – 12/2015/47

# 90 VJET

# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Titulli :

90 Vjet, Kontrolli i Lartë i Shtetit

Botimi u përgatit nga : Irena Islami & Amantja Patozi

Art Design: Elisa Metaj

Seria : botime KLSH - 12/2015/47

ISBN : 978-9928-159-38-0

Shtypur në Shtypshkronjën "ONUFRI"

Tiranë 2015

**PËRMBAJTJA** **Faqe**


**HYRJE**

**Kremtimi i 90 vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit**

**I. Ceremonia e kremtimit të 90 vjetorit të KLSH-së, në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**

- Fjala e hapjes, mbajtur nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ.
- Përshëndetje e z. Florjan NURI, Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës, në emër të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z Bujar NISHANI.
- Përshëndetje nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Z. Ilir META.
- Përshëndetje nga Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Vitor Manuel da SILVA CALDEIRA.
- Përshëndetje nga Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Dr.Josef MOSER.
- Mesazhi i Kontrollorit të Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA, z. Gene DODARO.
- Përshëndetje nga Zv/Presidenti i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, Prof. As. Dr. Recai AKYEL.
- Përshëndetje nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, z. Bashkim DEDJA.
- Përshëndetje nga Prof.Dr.Anastas ANGJELI, në emër të Akademisë së Shkencave.

- Përshëndetje nga Prof.Dr.Jorgji BOLLANO, në emër të Shoqatave të Profesionistëve të fushës së Ekonomisë.
- Përshëndetje nga z.Bashkim SPAHIJA, në emër të ish-audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- *" Historiku dhe veprimtaria e KLSH-së në 90 vjet"*, nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ .

## I. Aktivitete që shoqëruan ceremoninë e 90 vjetorit

- Ceremonia e dekorimit të Presidentit të Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Vitor Manuel da SILVA CALDEIRA, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.
- Ceremonia e dekorimit të Presidentit të Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Dr. Josef MOSER, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.
- Ceremonia e dekorimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar LESKAJ, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.
- Vizitë në Mini-Muzeun e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Ceremonia e akordimit të titullit *Qytetar Nderi,* Presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive, Prof.Asoc.Dr.Recai AKYEL, nga Bashkia e qytetit të Elbasanit.

- Ceremonia e akordimit të titullit *Qytetar Nderi,* Zv/Kryetarit të NIK-ut Polak, z.Wojciech Kutyla dhe ish-Kryetarit, z.Jacek Jezierski, nga Bashkia Orikum.

- Pritje për të ftuarit në Pallatin e Brigadave.

Gjatë pritjes, z.Arben Beqiraj, Zv/Kryetar i Bashkisë Vlorë, i dorëzoi titullin *Qytetar Nderi* i Vlorës, Presidentit të SAI-t Turk, Z. Recai AKYEL;

z. Fadil Begu, Kryetar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Peshkopi, i dorëzoi titullin *Qytetar Nderi* i Peshkopisë, Presidentit të SAI-t Kroat, z. Ivan KLESIÇ.

- Akordimi i titullit, *Mirënjohje e Qytetit*, nga z.Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë së Qytetit të Tiranës :
  -Z. Vitor Manuel da SILVA CALDEIRA, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve;
  -Z. Josef MOSER, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe
  - Z. Recai AKYEL, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive.

  Dhënia e titullit *Honoris Causa,* z. Vitor Manuel da SILVA CALDEIRA nga Universiteti i Tiranës.
- Vizitë në Galerinë e Arteve.
- Vizitë në Muzeun Arkeologjik të Durrësit.
- Akordimi i titullit *Qytetar Nderi,* Presidentit të SAI-t të Bosnje Hercegovinës, z.Milenko SEGO, nga Kryetari i Bashkisë Shijak në darkën Zyrtare në Vilën 31.
- Akordimi i titullit *Qytetar Nderi* i Qarkut Shkodër, Presidentit të Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z. Milan DABOVIÇ dhe Presidentit të SAI-t të Kroacisë, z. Ivan KLESIÇ, nga Kryetari i Qarkut Shkodër.

## II. Pasqyrimi në media i 90 vjetorit të KLSH-së.

## III. Letra falënderimi.

## HYRJE

Kujtesa institucionale e një organi kushtetues është e një rëndësie parësore për të lexuar drejt vlerat dhe kontributin e tij përgjatë viteve, por edhe gabimet dhe momentet e kthimeve prapa. Një analizë e tillë në dritën e fakteve të plota i shërben institucionit kushtetues për të kuptuar qartë pozicionin e tij në shoqëri, por edhe opinionit publik dhe qytetarëve për të peshuar si duhet misionin dhe realizimin e tij nga ky institucion.

Si KLSH, në 90-Vjetorin e krijimit të institucionit, duke iu referuar orientimit themelor të Kongresit të XXI-të, të INTOSAI-t, në tetor 2013 në Pekin, për vendosjen e auditimit kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare, kemi kënaqësinë të sjellim tek lexuesit këtë përmbledhje të kumtesave, përshëndetjeve dhe aktiviteteve kryesore për kremtimin e këtij jubileu. Sikurse e theksoi Gene L. DODARO, Audituesi i Përgjithshëm i GAO-s amerikane në përshëndetjen e tij drejtuar KLSH në 90 Vjetorin e krijimit të saj, "*Institucionet Supreme të auditimit sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën, jo vetëm për vendet e tyre, por në tërësi për të gjithë botën. Në nivel kombëtar, SAI-t ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe ndihmojnë drejtuesit publikë të planifikojnë të ardhmen*".

Duke e parë veten në këtë mision, kemi kërkuar identitetin institucional, nëpërmjet dokumentimit dhe hedhjes dritë të plotë mbi historine e zhvillimit të KLSH, si një përgjegjësi për brezat që vijnë, por edhe një shërbim për qytetarin, opinionin publik dhe partnerët tanë vendas dhe të huaj.

Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhet ngushtë me shpalljen nga deputetët e Kuvendit Kushtetues më datë 21 janar 1925 të krijimit të Republikës Parlamentare Shqiptare. Pas miratimit të Statutit Themeltar të Republikës Shqiptare, Presidenti i Republikës, Ahmet Zogu më datë 20 maj 1925 firmosi Dekret- Ligjin " Mbi formimin e

Këshillit Kontrollues", dekret që hyri në fuqi më datë 26 maj 1925. Ky këshill krijohej si organ kushtetues dhe nuk varej nga asnjë ministri.

Në vitet 1928-1939, vendi drejtohej nga një monarki institucionale. Me ligj të veçantë përcaktohej mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të Kontrollit Shtetëror, mënyra e raportimit në Parlament dhe marrëdhëniet e tij me qeverinë e mbretin.

Në Gusht të vitit 1946 bëhet riorganizimi tërësor i organeve të kontrollit, si në formë edhe në përmbajtje. Me ligj të veçantë të Kuvendit Popullor krijohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit, i cili ishte në përbërje të Qeverisë dhe në varësi të plotë prej saj (strukturë nën varësinë e ekzekutivit dhe të partisë-shtet), duke humbur pavarësinë dhe duke qenë në shërbim të politikës së shtetit totalitar.

Me vendosjen e pluralizmit në Shqipëri, me asistencën e BE u hartua projektligji "Për Shërbimin e Kontrollit të Shtetit", i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në 31 gusht 1992. Në këtë ligj sanksionohej se Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ishte organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar dhe i pavarur nga qeveria.

Pavarësia e plotë, depolitizimi dhe departizimi i organit suprem të kontrollit u realizuan me miratimin e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" dhe më pas të ligjit themelor të Shtetit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", pjesa e katërmbëdhjetë "Kontrolli i Lartë i Shtetit", nenet 162-165.

Në datën 27 nëntor 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri të KLSH-së, nr. 154/2014, "Mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH", i cili hyri në fuqi në shkurt 2015. Ky ligj realizon profilizimin e KLSH-së si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon aktivitetin e tij tërësisht në standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

KLSH gjatë gjithë periudhës së pluralizmit ka vepruar në mënyrë të pavarur, duke gëzuar pavarësi dhe duke u përpjekur të bashkëpunojë me institucionet homologe dhe partnerët ndërkombëtare. Në pamundësi të përmendjes së të gjithë figurave të

drejtuesve të KLSH ndër vite, do të veçoja personalitetet e ndritura, veçanërisht në vitet 1925-1944, si: Kol Thaçi, Lac Gera, Llambi Aleksi, Fejzi Alizoti, Lame Kareco, Eqerem Libohova, Xhaferr Ypi, Rrok Gera, Izedin Beshiri dhe të tjerë. Dëshiroj gjithashtu të vlerësoj punën reformuese të kryetarëve të KLSH-së në vitet e demokracisë, z.Zyhdi Pepa, z.Ylli Memisha, z.Stefan Papagjoni, Prof. Dr. Blerim Çela, z.Mustafa Kërçuku, z.Robert Çeku, etj.

Dëshiroj të shpreh falënderimet e mia për të gjithë përfaqësuesit e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare të Auditimit, drejtuesit e SAI-ve partnere që morën pjesë në kremtimet e 90 vjetorit dhe në vecanti Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Vitor Manuel da SILVA CALDEIRA, Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAIT, z.Josef MOSER, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Prof. As. Dr. Recai AKYEL, etj.

Një falënderim i veçantë për Presidentin e Republikës SH.T.Z. Bujar NISHANI dhe personalitet e shtetit shqiptar që vlerësuan këtë përvjetor dhe na nderuan me pjesëmarrjen e tyre.

Së fundmi, me mirënjohje të thellë shpreh konsideratën, respektin dhe vlerësimin maksimal për të gjithë trupën e audituesve dhe stafin mbështetës, të cilët me integritet, korrektesë dhe profesionalizëm kanë kontribuar dhe shërbyer në këtë institucion gjatë gjithë kësaj periudhë 90- vjeçare, duke pasur dëshirën e madhe dhe bindjen se 100-Vjetori i krijimit të KLSH-së do ta gjej këtë institucion mes Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) të vendeve anëtare të BE-së.

**Bujar Leskaj**



## FJALA E HAPJES, MBAJTUR NGA KRYETARI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT, Z. BUJAR LESKAJ NË CEREMONINE E 90- VJETORIT TË KLSH-së

*Pas interpretimit të Himnit Kombëtar nga Mjeshtri i madh Kastriot Tusha*

Faleminderit Mjeshtër i Madh

z.Kastriot Tusha;

I nderuari z. Ilir Meta, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

I nderuari President, z.Bamir Topi;

I nderuari z. Bashkim Dedja,

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese;

I nderuari z. Florjan Nuri, Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës;

Të nderuar Drejtues dhe Përfaqësues të Komuniteteve Fetare;

Të nderuar Deputetë, Përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe më gjerë;

Të nderuar zotërinj Ambasadorë;

*Të dashur Auditues,*

Më lejoni që edhe në emrin tuaj t'ju uroj mirëseardhjen në këtë ceremoni të 90-vjetorit të KLSH personaliteteve të auditimit të jashtëm publik Europian dhe drejtuesve të institucioneve supreme të auditimit nga Europa, zotërinjve:

Dr. Josef Moser, *Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAIT-t dhe President i Gjykatës Austriake të Auditimit;*

Dr. Vitor Caldeira, *President i Gjykatës Europiane të Audituesve*;

Prof.Ass.Dr. Recai Akyel, zv/ President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive;

z.Ivan Klesiç, *Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë;*

z.Milan Daboviç, *President i Senatit të Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi;*

z. Radoslav Sretenoviç, *President i Institucionit të Auditimit Shtetëror të Serbisë;*

z. Milenko Sego, *Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje Hercegovinë*s;

z. Wojciek Kutyla*, zv/President i SAI-t Polak*;

z. Cosmin Nicula, *zv/ President i SAI-t Rumun*;

z. Artan Venhari, *zv/Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës;*

z.Naser Ademi, *zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë,*

*dhe zotërinjve*

z. Robert Gielisse, *Këshilltar i Lartë në DG-Budget,*

z. Joop Vrojlik dhe të tjerë.

Në Kongresin e fundit të INTOSAI-t, INCOSAI XXI, në tetor 2013 në Pekin, tema qendrore ishte vendosja e auditimit kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare. Në Kongresin e fundit të EUROSAI-t, zhvilluar në qershor 2014 në Hagë të Holandës, tema qendrore ishte inovacioni, ose "Cila është hera e fundit që keni bërë një gjë për herë të pare?".

E pra sot, ne si KLSH, për herë të parë në historinë e institucionit kremtojmë 90 Vjetorin e krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të bindur se në 100 Vjetorin e tij, do të kemi një trupë akoma dhe më profesionale audituesish dhe me shpresën e madhe se Shqipëria do të jetë anëtare e Bashkimit Evropian. Natyrisht do të kemi dhe Kryetar të ri të KLSH atëherë.

Duke kremtuar 90 Vjetorin e krijimit sot, ne promovojmë dhe sjellim në vëmendje të publikut, partnerëve tanë vendas e të huaj, si dhe komunitetit ndërkombëtar, jo

vetëm historinë dhe trashëgiminë tonë institucionale por edhe mesazhet për drejtimet dhe sfidat kryesore të misionit dhe punës tonë në të ardhmen.

Misioni ynë, në dritën e orientimit themelor të Kongresit të fundit të INTOSAI-t, në Pekin, sipas përcaktimeve kushtetuese në Nenet 162-164, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në Nenin 1, të Deklaratës së Limës, e konsideruar si "*Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditmit*" është **rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike, në një shkallë më të gjerë, për të gjithë komunitetin të cilit një SAI i shërben Taksapaguesve, Publikut, Parlamentit dhe Organeve Ekzekutive, duke kufizuar ne maksimum abuzimet dhe duke siguruar përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë të këtyre fondeve**.

Sikurse ka orientuar Kongresi INCOSAI XXI, i INTOSAI-t, i cili tashmë është një dokument themeltar i institucioneve supreme të auditimit "*SAI-t mund të ndihmojnë duke rritur transparencën, duke siguruar përgjegjshmërinë, promovuar performancën, dhe duke luftuar korrupsionin, të përmirësojnë qeverisjen e mirë kombëtare dhe të rrisin paanshmërinë. Qëndrueshmëria afatgjatë e politikave financiare është një parakusht i pamohueshëm për qeverisjen e mirë kombëtare. SAI-et, nëpërmjet auditimit të pavarur profesional, mund të ndihmojnë vendimmarrësit publikë të ruajnë qëndrueshmërinë dhe zbatimin e politikave financiare, duke rritur transparencën, duke raportuar mbi performancën e financave publike dhe duke nënvizuar risqet e sistemit*.

Si një SAI që kërkon të zhvillohet me parametrat e SAI-ve të përparuara evropiane, ne si KLSH jemi të gatshëm të marrim përsipër këtë përgjegjësi, duke audituar në linjë me standardet e INTOSAI-t. Mbi ketë qasje të re që shtron Forumi më i lartë i komunitetit të INTOSAI-t, vizioni ynë është shndërrimi i audituesve të KLSH-së në një trupë moderne auditimi, që zbaton standardet ndërkombëtare ISSAI të INTOSAI-t në kushtet dhe specifikat e Shqipërisë, e aftë të përballojë sfidat e kohës për shëndoshjen e plotë dhe qëndrueshmërinë e financave publike, të thellojë transparencën dhe llogaridhënien, të luftojë në thellësi dhe në sistem korrupsionin, si dhe të bashkëpunojë me efektivitet dhe efiçiencë me institucionet simotra në Europë dhe më gjerë, si dhe me të gjithë partnerët tanë vendas.

Ne jemi të vendosur që të ruajmë dhe zhvillojmë vlerat e vërteta të punës profesionale audituese, të ruajmë pavarësinë, objektivitetin, integritetin, përgjegjshmërinë, profesionalizmin, bashkëpunimin, duke i shërbyer interesit publik; të thellojmë transparencën, duke përditësuar eksperiencën më të mire dhe të vyer të audituesve tanë me të rejat më të fundit të auditimit suprem modern, nën moton e INTOSAI-t "*Experentia mutua Omnibus Prodest*".

Me lejoni tani që të ftoj për të marrë fjalën Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, zotin Ilir Meta dhe njëherazi ta falenderoj për mbështetjen që na ka dhënë në vijimësi dhe veçanërisht me krijimin e kushteve për zhvillimin e kësaj ceremonie për ne, në këtë sallë të nderuar të Kuvendit të Shqipërisë.



*Kryetari i Kontrollit të Lartë të shtetit z. Bujar Leskaj gjatë hapjes së ceremonisë së 90 Vjetorit të KLSH-së*



*(Nga e majta në të djathtë):*
*Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta, Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive z. Recai Akyel gjatë hapjes së ceremonisë së 90 Vjetorit të KLSH-së.*

**Përshëndetja e Presidentit të Republikës Sh. T. Z. Bujar Nishani**

**në ceremoninë e 90-vjetorit**

**të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit**

*(Në emër te Presidentit te Republikës, SH.T.Z. Bujar Nishani, përshëndet Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës, z. Florjan Nuri)*



I nderuar Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, zoti Meta,

I nderuar President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, zoti Caldeira,

I nderuar Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës Austriake të Auditimit, zoti Moser,

I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, zoti Leskaj,

Të nderuar të pranishëm dhe pjesëmarrës,

Është nder dhe kënaqësi për mua që në cilësinë e President të Republikës së Shqipërisë jam ftuar të marrë pjesë në ceremonitë e 90-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në këtë rast dua të shpreh vlerësimin tim institucional, por edhe si qytetar i këtij vendi dhe të përshëndes Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotin Bujar Leskaj për nismën dhe angazhimin e tij personal në organizimin e kësaj ceremonie mjaft të rëndësishme që ky Institucion kremton për herë të parë në historinë e tij. Mund të konfirmoj me bindje se organizimi i veprimtarive të tilla kryhet vetëm nga individë vizionarë, të cilët janë të mbrujtur nga një patriotizëm e ndërgjegje e spikatur kombëtare dhe që synon në ruajtjen e identitetit dhe pasurimin e kujtesës dhe trashëgimisë historike.

Organizimi i këtij aktiviteti nuk është thjesht një ceremoni protokollare, por në konsideratat e mia ky aktivitet i kalon kufijtë rutinorë dhe vjen me një dimension, profil dhe vlerë mjaft të veçantë si në rrafshin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Nëpërmjet kësaj veprimtarie Kontrolli i Lartë i Shtetit sjell në vëmendje të opinionit ndërkombëtar, komunitetit të INTOSAI-t, si dhe të gjithë institucioneve të shtetit shqiptar, studiuesve e profesionistëve të fushës historikun e krijimit, funksionimit dhe zhvillimit të institucionit suprem të auditimit në Shqipëri, historik që i ka fillesat e tij nëntëdhjetë vite më parë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë ditë të përvjetorit të 90-të të krijimit të tij vjen me materiale, studime dhe botime të veçanta, të cilat janë rezultat i kërkimit shkencor, rrjedhojë e një pune të jashtëzakonshme bazuar në dokumente arkivore.

Nëse do i referohesha botimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të vitit 2012 "Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit", në vëmendje të publikut sillen periudhat e zhvillimeve ekonomike, shoqërore dhe politike të lidhura organikisht me zhvillimet në fushat e financave publike dhe rolin e institucionit suprem të auditimit në menaxhimin e financave publike ndër vite.

Pra, Kontrolli i Lartë i Shtetit hyn në analet e kujtesës dhe trashëgimisë historike me një kontribut dhe histori e dokumentuar, ku janë përjetësuar ngjarje zhvillime dhe figura të rëndësishme, të cilat kanë kontribuar në zhvillimin e këtij institucioni.

Mund të konfirmohet që historiku i evoluimit të Institucionit Suprem të Auditimit dhe përvoja e mbartur në vite, tipologjitë institucionale në rrjedhën historike, deformimet e pësuara gjatë periudhës së komunizmit dhe diktaturës dhe zhvillimi jo i qëndrueshëm pas viteve 1990-të përbëjnë një vlerë, aset të çmuar dhe pa dyshim një platformë mjaft konstruktive për të shënuar përparim dhe ecur dhe më tej në rrugën e modernizimit institucional.

Kjo veprimtari është dëshmi e pakundërshtueshme e rrugës pa kthim që ka marrë ky Institucion drejt progresit dhe përmbushjes së objektivave në kuadrin e integrimit evropian, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t në funksion të promovimit të një qeverisje të mirë, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Në këtë aspekt e konsideroj si një mundësi për të shprehur konsideratat dhe vlerësimin tim për progresin efektiv që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka shënuar këto tre vitet e fundit, periudhë kjo e frytshme në të gjitha dimensionet, rrjedhojë e një drejtimi dhe menaxhimi vizionar e institucional të zotit Leskaj, ku në kontekstin e këtij aktiviteti do të përmendja:

Në tre vitet e fundit, Kontrolli i Lartë i Shtetit realizoi tre Konferenca Shkencore, një praktikë risi për këtë Institucion, ndër të cilat do të përmendja organizimin e Konferencës së Parë Shkencore, të zhvilluar në dhjetor 2012, një forum kushtuar tërësisht historikut të Kontrollit të Lartë të Shtetit në 87-vjetorin e themelimit të tij dhe pikërisht në 100-vjetorin e Pavarësisë së shtetit shqiptar.

Në funksion të realizimit të misionit kushtetues të Institucionit për të informuar publikun dhe Kuvendin, si dhe në zbatim të standardeve profesionale INTOSAI mbi komunikimin, Kontrolli i Lartë i Shtetit në harkun kohor të tre viteve ka botuar në

periudhën janar 2012-maj 2015 në total 41 botime, duke reflektuar në to përvojën dhe praktikat më të mira të fushës.

Por krahas sa më sipër, me kënaqësi do të përmendja angazhimin dhe rolin e madh kontribues që aktualisht po luan Kontrolli i Lartë i Shtetit në mirëadministrimin e financave shqiptare.

Nuk do të doja ta mbyllja këtë përshëndetje të shkurtër pa shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin tim personal dhe institucional për të gjithë ata breza punonjësish, që ndër vite kanë kontribuar në zhvillimin e këtij Institucioni.

Në përfundim ju përcjell urimet më të mira për organizimin e suksesshëm të ceremonisë së 90-vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***Ju faleminderit!***




*Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës, z. Florjan Nuri*





**Përshëndetja e Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta gjatë ceremonisë së 90-vjetorit të krijimit të KLSH-së**



I nderuar z. Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

I nderuar z. President i Gjykatës Europiane të Audituesve,

I nderuar z. President i Gjykatës Austriake të Auditimit,

I nderuar z. Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,

I nderuar z. ish-President, Bamir Topi,

Të nderuar deputetë dhe përfaqësues të institucioneve, zonja dhe zotërinj!

Kur përmendim 90-vjetorin e një prej institucioneve, që në themel të punës së tij ka mbrojtjen dhe garantimin e financave të shtetit, duhet të ndihemi krenarë që shteti shqiptar dhe themeluesit e tij, që prej vendosjes së pavarësisë në vitin 1912, kanë patur largpamësinë për të krijuar një strukturë të pavarur shtetërore, që do të mbikëqyrte mënyrën e shpenzimit të asaj arke simbolike të shtetit të ri të sapo krijuar. Me vendosjen e sistemit demokratik në Shqipëri, ashtu si gjithë institucionet shtetërore dhe publike, edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit iu nënshtrua reformimit institucional, kushtetues e ligjor me qëllim për t'iu qasur standardeve bashkëkohore ndërkombëtare, parimeve të shtetit ligjor dhe rregullave të ekonomisë së tregut.

Me miratimin e ligjit organik të Kontrollit të Lartë të Shtetit për herë të parë u hodhëm bazat e qarta të një institucioni të depolitizuar dhe të departizuar. Sot vërejmë me kënaqësi se me kalimin e viteve të trancizionit dhe me fillimin e

proceseve për integrimin e Shqipërisë në strukturat euro-atlantike, KLSH-ja ashtu si edhe institucione të tjera të pavarura kushtetuese kanë rritur shkallën e përgjegjshmërisë për të përmbushur, jo vetëm objektivat afatshkurtër e afatmesëm institucionale, por edhe për të ngritur në një nivel akoma më të lartë shkallën e bashkëpunimit dhe të bashkëveprimit me institucionet ligjzbatuese si edhe përfaqësimin në strukturat ndërkombëtare, INTOSAI dhe EUROSAI, anëtare e të cilave KLSH është prej vitit 1993.

Ky institucion kushtetues që zgjidhet e shkarkohet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës realisht gëzon një pavarësi institucionale, organizative dhe funksionale. Një nga sfidat që ka shoqëruar jo vetëm funksionimin e KLSH-së por edhe mazhorancat që kanë zgjedhur titullarin e këtij institucioni është shmangia nga ndikimi politik i veprimtarisë së KLSH-së për t'u përdorur si mjet ndëshkues në kohën e rotacioneve politike. Mendoj se marrëdhënia e përgjegjësisë reciproke, bashkëpunuese e konstruktive që ekziston midis Kuvendit dhe KLSH-së ofron një vlerë të shtuar jo vetëm për parametrat e mirëqeverisjes në Shqipëri, por edhe si një kontribut në kuadër të avancimit të integrimit evropian të vendit tonë. Këtë shkallë të lartë të bashkëpunimit, Kuvendi i Shqipërisë e ka reflektuar qartazi gjatë këtij mandati qeverisës, ku organet drejtuese të Kuvendit dhe Komisioni i Ekonomisë vlerësuan dhe morën në konsideratë propozimin e kryetarit të KLSH-së për të reflektuar ndryshime në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni.

Gjatë vitit 2014, tre komisione të përhershme parlamentare, ai i Ekonomisë në cilësinë e komisionit përgjegjës, si dhe Komisioni i Ligjeve dhe ai i Integrimit Evropian zhvilluan një proces intensiv të shqyrtimit të nismës ligjvënëse të paraqitur nga Kryetari i Komisionit të Ekonomisë.

Pas një pune shumë të specializuar, diskutimi i shqyrtimit të nismës si edhe pas zhvillimit të një tryeze me ekspertë dhe partnerë ndërkombëtarë, Kuvendi më 27 nëntor 2014, miratoi ligjin e ri për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, i cili është në përputhje të plotë me standardet bashkëkohore ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit.

Ligji i ri synon përdorimin me efikasitet të pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut nëpërmjet publikimit të raporteve në përputhje edhe me parimin e transparencës në funksionimin e institucionit me qëllim mbrojtjen e fondeve publike nga abuzimet dhe shpërdorimet dhe ndëshkimin e rasteve korruptive.

Dua t'ju siguroj për vullnetin tonë maksimal për ta forcuar më tej bashkëpunimin e ngushtë që Kuvendi gëzon sot me KLSH-në. Përveç detyrimit ligjor që ka KLSH-ja për të raportuar në Kuvend për veprimtarinë vjetore në kuadër të ushtrimit të funksionit kontrollues të Kuvendit dhe të paraqitjes së raportit të paraqitjes së buxhetit të shtetit, ne tashmë jemi pjesë e përbashkët të përmbushjes së detyrimeve të udhërrëfyesit për pesë prioritetet për integrimin në Bashkimin Europian.

Në këtë kuadër ne si pushtet legjislativ jemi të angazhuar për të garantuar pavarësinë financiare të KLSH-së si dhe pavarësinë e funksionimit dhe drejtimit të saj në përputhje me parimet kushtetuese, legjislacionet e brendshme dhe parimet bazë të drejtimit që rrjedhin nga deklarata e Limës, standardet e kontrollit të INTOSAI-t dhe udhëzuesit evropian të zbatimit. Në kuadër të marrëdhënieve bashkëpunuese

KLSH-së ka dhënë një ndihmesë dhe një kontribut të veçantë edhe në procesin e reformës tepër të rëndësishme administrative-territoriale vitin e kaluar, duke kontribuar në këtë proces me një studim të posaçëm për auditimin e performancës me objekt ndarjen administrative-territoriale dhe parandalimin e luftës kundër korrupsionit në keqqeverisje dhe keqpërdorimin e fondeve publike të pushtetit vendor, ku konkludohej me domosdoshmërinë e kryerjes së kësaj reforme.

Kuvendi i Shqipërisë e inkurajon KLSH-në që të vijojë me intensitetin e duhur me objektivat që burojnë nga strategjia për zhvillim 2013-2017 dhe nga plani i veprimit për realizimin e saj.

Ndaj edhe dëshiroj të theksoj në përfundim se Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të mbajë në konsideratë rezolutat e Kuvendit, gjetjet dhe rekomandimet e progres-raporteve të Komisionit Europian, duke dëshiruar që ky institucion të vazhdojë

konsolidimin e standardeve më bashkëkohore ndërkombëtare të kontrollit. Edhe një herë ju falënderoj për punën dhe ju uroj 90-vjetorin.

**Suksese!**

*Foto të marra gjatë fjalës përshëndetëse të Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta në ceremoninë e 90-vjetorit të krijimit të KLSH-së*








**Përshëndetja e z.Vitor Manuel da Silva Caldeira, *President i Gjykatës Europiane të Audituesve***



I nderuar Kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Leskaj,

Të nderuar kolegë, zonja dhe zotërinj!

Është një nder i madh që ftohem për të folur në këtë ngjarje të rëndësishme, e cila shënon 90 vjetorin e Institucionit Suprem të Auditimit të Republikës së Shqipërisë.

Europa ka jetuar kohë dhe momente shumë të vështira, duke përfshirë Luftën e Dytë Botërore, rënien e komunizmit dhe shpërbërjen e Jugosllavisë.

Megjithatë, shtetet e Europës janë tani më demokratike dhe më të integruara se kurrë më parë. Bashkimi Europian ka qenë nxitësi kryesor i këtij ndryshimi për më shumë se 50 vjet.

Jean Monnet, si një nga figurat themeluese të BE-së, është shprehur:

*"Asgjë nuk është e mundur pa individin, asgjë nuk është e qëndrueshme pa institucione".*

Ajo që filloi në vitin 1958 si një komunitet prej gjashtë kombesh, tani është një bashkim i 28 shteteve anëtare, me vende të tjera europiane si Shqipëria, kandidat për anëtarësim. Ky bashkim shtetesh  është angazhuar për promovimin e paqes, mirëqenien e qytetarëve të saj dhe vlerat e përbashkëta, duke përfshirë demokracinë.

Gjatë kësaj periudhë, Institucionet Supreme të Auditimit janë njohur si institucionet kryesore të shtetit, për çdo demokraci funksionale. Kjo për arsye se SAI-t në bashkëpunim me Parlamentet luajnë një rol vendimtar për t'i mbajtur qeveritë të përgjegjshme për qytetarët dhe për të promovuar qeverisjen e mirë publike e menaxhimin financiar.

Ky rol i SAI-ve ka qenë i njohur prej kohësh nga Bashkimi Evropian por është njohur dhe më tepër kohët e fundit nga një rezolutë e rëndësishme e OKB-së. Në fakt, të pasurit e një SAI  të pavarur është një parakusht për t'u bërë një shtet anëtar i BE-së. Prandaj, ngritja e kapaciteteve të SAI-t  është një pjesë e rëndësishme e procesit për vendet kandidate si Shqipëria që do t'i bashkohen BE.

Unë mendoj se sot ne mund të festojmë zhvillimin e SAI-t të Shqipërisë dhe kontributin e tij për të ndihmuar Shqipërinë për anëtarësimin në BE.

Unë e kuptoj se Ligji i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit i Shqipërisë do të lehtësojë këtë kontribut. Ndër të tjera, besoj se ky ligj e sjell auditimin e jashtëm të fondeve publike në Shqipëri në përputhje me standardet ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit. Si pjesë e reformave të menaxhimit të financave publike në Shqipëri, ligji i ri ndihmon për çeljen e rrugës drejt  BE për të siguruar mbështetje të mëtejshme financiare.

Unë jam i sigurt se përpjekjet e KLSH-së në vitet e fundit për të ndërtuar kapacitetin e saj do ta pozicionojnë atë në një vend të mirë për të përmbushur sfidat e auditimit, të cilat nënkuptojnë reformën e menaxhimit të financave publike në Shqipëri, si dhe për të kontribuar në suksesin e institucionit. Por ndërtimi i kapacitetit të KLSH nuk është vetëm për vendet kandidate. Të gjitha SAI-t duhet të punojnë për ngritjen e kapaciteteve për t'ju përshtatur ndryshimeve globale që po ndodhin në shoqëri dhe qeveri.

Shtetet më shumë se kurrë më parë, në mënyra të ndryshme pritet të ofrojnë shërbime më komplekse për qytetarët e tyre. Kjo është e vërtetë për të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe unë jam i sigurt se ky është edhe rasti i Shqipërisë.

Tashmë që qeverisja dhe financat publike janë bërë më moderne dhe detyra për auditimin e këtyre aktiviteteve do të bëhet edhe më e kërkuar. Kjo gjithashtu do t'u japë SAI-ve një mundësi për ti dhënë formën më të mirë ndryshimeve në qeverisjen publike. Në veçanti, ne japim shembullin për çështje të tilla të rëndësishme si forcimi i përgjegjshmërisë demokratike, transparencës dhe angazhimeve në auditimin publik.

Si një komunitet i SAI-ve, është thelbësore që ne të gjithë të ndihmojnë njëri-tjetrin duke ndarë përvojën tonë, duke vazhduar zhvillimin e standardeve tona profesionale dhe në rastin e vendeve të BE-së dhe kandidate, edhe duke koordinuar punën tonë të auditimit.

***I dashur z.Leskaj,***

Unë mund t'ju siguroj se Gjykata Evropiane e Audituesve do të vazhdojë të mbështesë institucionin tuaj në adresimin e sfidave të auditimit, me të cilat do të përballet KLSH si institucion i një vendi kandidat. Ne kemi tashmë një bashkëpunim shumë të mirë mes SAI-ve të BE-së, si dhe të ECA me SAI-t e vendeve kandidate, siç është Republika e Shqipërisë.

Në veçanti, të dy institucionet tona kanë bashkëpunuar në mënyrë aktive brenda kuadrit të asaj që njihet si "Rrjeti i SAI-eve të vendeve kandidate dhe vendet kandidate të mundshme".

Për shembull, Shqipëria ka marrë pjesë në një projekt paralel auditimi të performancës për efektivitetin e energjisë, i cili organizohet dhe udhëhiqet nga SAI Suedez. Workshop-i i parë u mbajt në Shqipëri në Qershor 2014 dhe workshop-i i pestë dhe i fundit u mbajt javën e kaluar në ECA në Luksemburg.

Unë jam i kënaqur të them se tashmë është duke u planifikuar një projekt i ECA, i cili mbështet fuqishëm këtë iniciativë dhe ne jemi të gatshëm edhe një herë për të siguruar ekspertë, sipas nevojës. Këtë vit, ne gjithashtu kemi hapur disa nga kurset kryesore tona të trajnimit të brendshëm për audituesit nga SAI-t në rrjetin e vendeve kandidate. Unë jam shumë i kënaqur të them se 6 auditues nga KLSH kanë ka marrë pjesë në këto trajnime.

Për më tepër, ne jemi gjithashtu shumë të kënaqur që kemi mirëpritur audituesit nga Shqipëria të cilët i janë bashkuar programit të praktikës në ECA. Aktualisht kemi tre praktikantë shqiptarë në institucionin tonë.

Pra, më lejoni të përfundoj duke thënë se ECA shikon përpara për të vazhduar për të shkëmbyer përvojat dhe për të bashkëpunuar me KLSH-në për auditimin e fondeve të BE-së në Shqipëri.

***Z. Kryetar, zonja dhe zotërinj,***

Me rastin e 90 vjetorit të krijimit të institucionit, unë do të doja t'ju uroja kolegëve të Institucionit Suprem të Auditimit të Shqipërisë, gjitha të mirat për sfidat e së ardhmes!

***Faleminderit!***


KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
1925-2015
90 Vjet KLSH
90 YEARS
ALSAI

## Përshëndetja e Dr.Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t



I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

I nderuar z.Nuri, përfaqësues i Presidentit të Republikës,

I nderuar z. Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj,

Të nderuar kolegë,

Zonja dhe Zotërinj,

*Ju përgëzoj për 90 vjetorin e ALSAI-t!*

Me rastin e 90 vjetorit të Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Ju uroj përzemërsisht Ju Z. Bujar Leskaj, stafin Tuaj, si dhe të gjithë institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Si President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i përgjithshëm i INTOSAI, do doja t'Ju shprehja mirënjohjen për ftesën për të vizituar Shqipërinë, pasi ky gjest thekson edhe njëherë rëndësinë që i jep Kontrolli i Lartë i Shtetit transparencës dhe përgjegjshmërisë, si në marrëdhëniet dypalëshe, ashtu edhe në ato shumë palëshe, veçanërisht me Gjykatën Austriake të Auditimit dhe Sekretariatin e Përgjithshëm të INTOSAI-t.

### *Marrëveshja dypalëshe me ACA*

Prezenca ime sot mes jush, në këtë rast të veçantë, është tepër e rëndësishme, pasi marrëdhëniet e bashkëpunimit mes dy institucioneve tona kanë zgjatur prej vitesh. Kontaktet e para mes ACA dhe KLSH kanë nisur në fillimet e viteve 90, kur institucionit tonë ju kërkua një opinion mbi draftimin e një ligji për kontrollin ekonomik dhe financiar, si bazat për themelimin e një institucioni auditimi publik të jashtëm, të përmirësuar.

Ky kontakt fillestar, çoi më tej në një takim dypalësh në Austri, në vitin 1992, i cili kishte si qëllim të mbështeste hartimin e një ligji për auditimin e jashtëm publik në Shqipëri. Kjo marrëdhënie e suksesshme besimi mes dy organizatave tona, ishte baza për shkëmbime të ndryshme të mëvonshme që lidheshin me amendime dhe ndryshime ligjore për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Megjithatë, kryefjala e kësaj marrëdhënie nuk ishte vetëm baza ligjore, pasi ndër vite institucionet tona kanë diskutuar edhe për shumë tema të ndryshme që lidhen me auditimin e jashtëm publik. Kjo marrëdhënie shkëmbimi është konkretizuar më tej me nënshkrimin e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit, përkatësisht në vitin 1994 dhe 2013.

Gjykata Austriake e Auditimit, ka qenë dhe do të mbetet një nga mbështetëset kryesore për punën e institucioneve supreme të auditimit. Por ky bashkëpunim nuk është vetëm i njëanshëm, pasi mund të them se edhe ne po mësojmë shumë nga kjo marrëdhënie shkëmbimi. Kjo marrëdhënie po forcon gjithashtu organizatën tonë, si dhe po na bën të mundur të reflektojmë mbi proceset dhe qasjet tona, çka nxjerr në pah moton e INTOSAI “Experientia Mutua Omnibus Prodest”.

### *Angazhimi ndërkombëtar i Kontrollit të Lartë të Shtetit*

Për sa i përket INTOSAI, kontaktet e para mes dy institucioneve janë shënuar në vitin 1962. Megjithatë, u desh shumë kohë deri në vendosjen e një marrëdhënie të përbashkët, e cila ndodhi në vitin 1984 kur institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit u bë pjesë e INTOSAI. Deri në atë moment, institucioni i Kontrollit të Lartë të

Shtetit, kishte qenë pjesë e komiteteve të ndryshme për shkëmbimin e njohurive, brenda INTOSAI. Po kështu, edhe në kuadrin e Bashkimit Europian, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit është një anëtar aktiv brenda rrjetit të SAI-ve kandidate dhe kandidate të mundshme.

Fokusi i aktiviteteve ndërkombëtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit, shtrihet në njërën anë drejt EUROSAI dhe Grupeve të saj të Punës, ku Kontrolli i Lartë i Shtetit është anëtar i Grupit të punës IT, grupit të punës për Auditimin e Mjedisit, Grupit të Punës për Auditimin e fatkeqësive dhe katastrofave natyrore, si dhe Task Force mbi Auditimin dhe etikën dhe nga ana tjetër, Kontrolli i Lartë i Shtetit ruan një gamë të gjerë të kontakteve bilaterale - siç e përmenda më parë, edhe me Gjykatën Austriake të Auditimit.

Diçka tjetër unike që duhet përmendur për SAI-n tuaj, është edhe kontributi i vyer që ju jepni nëpërmjet organizimit të konferencave shkencore vjetore, gjë që ndihmon së tepërmi krijimin e një lidhje mes tematikave shkencore mbi auditimin, me eksperiencën audituese në praktikë, e gjitha në linjë me moton e INTOSAI “Experientia Mutua Omnibus Prodest”.

Të gjithë këta shembuj tregojnë se institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kthyer në një anëtar aktiv në komunitetin Europian dhe ndërkombëtar të SAI-ve dhe se puna dhe kontributi i këtij institucioni vlerësohet së tepërmi nga SAI-t homologe.

Po kështu, edhe prania këtu sot e zyrtarëve më të lartë të vendit, tregon se puna e këtij institucioni vlerësohet së tepërmi edhe në nivel kombëtar, si dhe thekson rëndësinë e procesit të kontrollit financiar në Shqipëri, i cili është thelbësor për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të financave publike. Zhvillimi i qëndrueshëm i financave publike është me rëndësi për çdo vend, ashtu siç është theksuar edhe në rezolutat e Kombeve të Bashkuara të viteve 2011 dhe 2014, përkatësisht, A/66/209 dhe A/69/228, mbi përmirësimin e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar pavarësinë, kapacitetet dhe sistemin e llogaridhënies publike të SAI-ve.

***Parakushtet për auditimin e zhvillimit të qëndrueshëm të financave publike.***

Pavarësia e një SAI përbën thelbin për sigurimin e mirë qeverisjes, transparencës, përgjegjshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, Gjykata Austriake e Auditimit, në cilësinë e Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI, ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët me Agjencinë Austriake për Zhvillim (Projekti INTOSAI Peer Review), lidhur me pavarësinë e SAI-ve.

Ky projekt do të realizohet mbi bazën e 8 parimeve të pavarësisë, të përcaktuara në Deklaratën e Meksikos dhe në përputhje me ISSAI 5600.

Qëllimi i këtij projekti është:

- Nga njëra anë do të shërbejë për identifikimin e problemeve dhe rekomandimeve që lidhen me 8 parimet e pavarësisë, duke e përdorur raportin si një mjet efektiv për aksesin ndaj parlamentit dhe medias.
- Nga ana tjetër ky projekt do të ndihmojë gjithashtu të gjithë komunitetin INTOSAI, në identifikimin si dhe marrjen e masave të mëtejshme për përmirësimin e pavarësisë, bazuar në rezultatet e Peer Review, së bashku me OKB dhe donatorët.

Gjithashtu, në përfundim të këtij projekti, duhet të bëhet e mundur që SAI-t të sigurojnë informacione konkrete, të pavarur dhe kosto-efektiv, në mënyrë që vendim-marrësit dhe publiku i gjerë të informohen në kohë rreth:

- Detyrave konkrete që lidhen me auditimin e qëndrueshmërisë financiare dhe limitet e saj;
- Kufizimet për përmbushjen me efektivitet të këtyre detyrave,
- Rëndësinë e promovimit aktiv të zbatimit të parimeve të Lima dhe Meksiko, si dhe rezolutat respektive të OKB A/66/209 dhe A/69/228.

Angazhimi i Shqipërisë dhe i KLSH kundrejt zhvillimit të qëndrueshëm, theksohet veçanërisht në gadishmërinë e këtij vendi për t'ju nënshtruar procesit të *Peer Review*,

në mënyrë që të zhvillojë më tej procesin e saj auditues. Jam i lumtur që brenda EUROSAI, SAI i Shqipërisë doli vullnetar për t'ju nënshtruar këtij projekti, si dhe që ne Gjykata Austriake e Auditimit dhe Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI, do të kontribuojmë në përforcimin e pavarësisë dhe efektivitetit të SAI-t Shqiptar.

Në këtë kontekst, do të doja t'Ju falënderoja Ju Kryetar, në emër të gjithë anëtarëve dhe stafit të punës së Gjykatës dhe komunitetit INTOSAI, për nominimin tim, si dhe Presidentin e Republikës, për akordimin e "Medaljes së Mirënjohjes". E pranoj me shumë kënaqësi këtë dekoratë, pasi ajo tregon një shenjë të fortë miqësie dhe partneriteti mes Shqipërisë, Austrisë dhe INTOSAI-t.

Nëpërmjet këtij eventi, me rastin e 90 vjetorit të themelimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Shqipëria ka zgjedhur mënyrën për të theksuar rëndësinë dhe përgjegjësinë e këtij institucioni kundrejt transparencës dhe llogaridhënies, si dhe për sfidat aktuale ndaj zhvillimit të qëndrueshëm.

Me këtë rast, unë do të doja të falënderoja institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Ju z. Bujar Leskaj, si dhe të gjithë stafin tuaj, jo vetëm me rastin e 90 vjetorit të krijimit të këtij institucioni, por edhe për iniciativën për të nxjerrë në pah para përfaqësuesve kombëtarë, rolin dhe shqetësimet që lidhen me këtë institucion.

Kam bindjen se institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit do të vazhdojë përpjekjet për të kontribuar në përforcimin e transparencës dhe pavarësisë edhe në 90 vjetët e ardhshme, duke siguruar në këtë mënyrë përfitime për qytetarët dhe duke përforcuar besimin e tyre.

***Ju faleminderit për vëmendjen!***




*Z. Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t*

**Mesazh drejtuar institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë**

*Nga: Z.Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës*



Mirëdita. Unë quhem Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara dhe Drejtues i Zyrës së Auditimit të Qeverisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, GAO siç na referohen shpesh. Ka qenë kënaqësi e madhe për mua të takohesha me Kryetarin e KLSH-së, Dr.Bujar Leskajn në Washington D.C në janar të këtij viti. Dëshiroj të falenderoj Dr. Leskaj për ftesën që më bëri për të dhënë këtë mesazh me rastin e 90-vjetorit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë.

Dëshiroj gjithashtu të falenderoj Presidentin e Gjykatës Europiane të Audituesve, z.Vitor Caldeira, Presidentin e Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Dr. Josef Moser, Euro-Parlamentarin, z. Igor Soltes, si dhe të ftuarit e nderuar në këtë sallë.

Me rastin e 90 vjetorit, dëshiroj të uroj të gjithë punonjësit e KLSH-së mbi rolin e rëndësishëm që institucioni juaj luan në promovimin e përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë. Institucionet Supreme të Auditimit janë vitalë për të ndihmuar përmirësimin e performancës së qeverisë, për të arritur më shumë transparencë, si dhe për të siguruar përgjegjshmëri në kontekstin e sfidave aktuale. Sipas mendimit tim, e ardhmja e auditimit të qeverisë është më e rëndësishme se kurrë. SAI-t si KLSH, dhe institucioni që unë drejtoj, kanë mundësi të jashtëzakonshme për të

ndihmuar qeveritë e tyre të planifikojnë për të ardhmen dhe të ngrenë tematika me interes për të gjithë.

Takimi që zhvillova me Dr. Leskaj në fillim të këtij viti, ishte një mënyrë shumë e mirë për të mësuar më shumë për institucionet tona të auditimit dhe sesi ne i përmbushim përgjegjësitë tona. Pres me padurim për mundësi të tjera ndërmjet dy institucioneve tona, me qëllim që të shkëmbejmë eksperiencat mbi çështje me interes të përbashkët.

Në GAO, ne nuk marrim vendime mbi politikat. Kjo i përket Kongresit por ne besojmë se me informacione të sakta dhe të kuptueshme, zyrtarët publikë janë në gjendje të vendosin duke qenë të informuar. Informacionet e paanshme dhe të besueshme nga SAI-t janë një nevojë urgjente, duke marrë parasysh sfidat e shumta fiskale, shoqërore, ekonomike dhe të sigurisë që ndeshin vendet anembanë botës. GAO është gjithashtu e vendosur për ta mbajtur publikun të informuar mbi punën e saj. Ne besojmë plotësisht në transparencën, në idenë se qytetarët duhet të jenë të informuar sa më shumë të jetë e mundur mbi rezultatet e performancës së qeverisë. Sipas mendimit tim, të kuptuarit nga publiku dhe mbështetja e tij, do të jenë thelbësore në adresimin e politikave të vështira që shtrihen përpara nesh.

Ndërsa SAI-t mund të luajnë një rol kyç në dhënien e informacioneve dhe analizave të rëndësishme zyrtarëve publikë, të cilat janë të nevojshme për të adresuar sfidat specifike të vendit, është gjithashtu e vërtetë se shumë nga problemet që ne hasim sot, janë të një natyre globale dhe kërkojnë bashkëpunim dhe zgjidhje ndërkombëtare.

Unë e di se Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë e ka të qartë rëndësinë e INTOSAI-t për anëtarët e tij dhe auditimin e qeverive në të ardhmen. Si një organizatë autonome, e pavarur dhe jo politike, INTOSAI ofron vendin ku institucionet supreme të kontrollit mund të punojnë së bashku dhe të ndajnë eksperiencat e tyre. Këto eksperienca variojnë nga strategjitë e bazuara në mësimet e mësuara tek praktikat më të mira si rrjedhojë e historive të suksesit. INTOSAI ofron gjithashtu një vend ku këto institucione mund të shkëmbejnë sfidat e tyre. INTOSAI ka patur një rol shumë të

rëndësishëm në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, si dhe në ndihmën ndaj kombeve kudo në botë, për të zbatuar këto standarde. Këto standarde kanë për qëllim të ruajnë pavarësinë dhe auditimin efektiv. Ato gjithashtu mbështesin anëtarët e INTOSAI-t në zhvillimin e qasjeve të tyre profesionale mbi bazat e mandateve specifikë të vendeve të tyre.

Rëndësia e nxitjes së zbatimit dhe aplikimit të këtyre standardeve reflektohet në interesimin e shfaqur nga komuniteti i donatorëve. Ashtu si dhe shumë nga ju e dinë, Bashkëpunimi i Donatorëve i INTOSAI-t filloi në 2009 kur 15 organizata donatore dhe vende të ndryshme nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për të rritur dhe forcuar mbështetjen ndaj SAI-ve, duke forcuar kështu qeverisjen, përgjegjshmërinë dhe kontributin në rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë. Që prej asaj kohe, 7 donatorë të tjerë e kanë nënshkruar këtë memorandum.

Grupi i Punës i INTOSAI-t për Modernizimin Financiar dhe Reformat Rregullatore është një tjetër shembull i shkëlqyer i SAI-ve të vendeve të ndryshme që mblidhen së bashku për të përballuar sfidat globale. Në 2012 Bordi Drejtues i INTOSAI-t miratoi krijimin e këtij Grupi Pune. Duke bërë këtë, Bordi njohu se komuniteti i INTOSAI-t duhet të vazhdojë të zhvillojë ekspertizën e tij dhe aftësitë, në mënyrë që të përballojë sfidat, ndërthurur kjo dhe me mbikëqyrjen e sistemit aktual financiar global.

Si drejtues i GAO-s, unë kam mësuar shumë nga eksperiencat tona të shumta në INTOSAI, duke përfshirë angazhimin tonë në zhvillimin e dy planeve të parë strategjikë të INTOSAI-t. Si Kryetar i Task Forcës mbi Planifikimin Strategjik që e ka fillesën në planin e tretë strategjik të INTOSAI-t, unë dhe kolegët e mi të kësaj task force, jemi të vendosur të zgjerojmë bashkëpunimin kudo në INTOSAI. Ne mirëpresim të gjithë kontributin për të identifikuar sesi Plani Strategjik 2017-2022 mund të vihet në shërbimin më të mirë ndaj nevojave të anëtarëve dhe sesi ai mund të ndriçojë më së miri rrugën tonë dhe zhvillimin në të ardhmen. Është e rëndësishme për ne të reflektojmë mbi diversitetin e INTOSAI-t si një prej pikave të tij më të forta dhe si një burim vlere për secilin SAI. Plani i ri është menduar të mbështetet mbi funksionet bazë të INTOSAI-t dhe arritjet në përcaktimin e

standardeve, zhvillimin e kapaciteteve të SAI-ve dhe shkëmbimin e njohurive. Task Forca është e angazhuar që të sigurojë se struktura drejtuese e INTOSAI-t reflekton prioritetet ambicioze dhe të rëndësishme të organizatës sonë.

Institucionet Supreme të auditimit sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën, jo vetëm për vendet e tyre, por në tërësi për të gjithë botën. Në nivel kombëtar, SAI-t ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe ndihmojnë liderët e tyre të planifikojnë për të ardhmen. Në nivel ndërkombëtar, puna me homologët e tyre, i ndihmon të zgjidhin problemet e hasura.

Dëshiroj të shpreh urimet e mia më të mira për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Dr. Leskajn, si dhe për vazhdimësinë e përpjekjeve tuaja në shërbim të mirë qeverisjes.

Pres me padurim të punoj me ju për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve tona. E vlerësoj së tepërmi që jam pjesë e ceremonisë suaj.

***Ditën e mirë!***




KANALI - 1
CHANNEL - 1

**Përshëndetje e Zv/Presidentit të Bordit Drejtues të EUROSAI-t dhe Presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive, Prof. Ass.Dr. Recai Akyel**



I dashur z. Ilir Meta, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë,

Të dashur anëtarë të Parlamentit,

z. Caldeira,

z. Moser,

I dashur z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

Të dashur Presidentë të SAI-ve,

Të dashur të ftuar,

Të dashur kolegë,

Zonja dhe Zotërinj,

Dëshiroj fillimisht të shpreh falënderimet e përzemërta për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për ftesën që më bëri në një event kaq special dhe që më dha mundësinë t'i drejtohem një audience të nderuar në emër të Bordit Drejtues të EUROSAI-t. Është një nder i madh për mua që të jem këtu me ju në festimin e 90 vjetorit të themelimit të KLSH. Më lejoni të shpreh urimet e mia më të sinqerta për ju, z. Leskaj, dhe për të gjithë kolegët e KLSH në këtë ngjarje të veçantë. Do të doja të shprehja përshëndetje të sinqerta nga Bordi Drejtues i EUROSAI-t dhe nga Gjykata Turke e Llogarive.

Unë jam shumë i lumtur që jam në Shqipëri sot dhe ju sjell përshëndetjet më të ngrohta nga Turqia. Unë jam shumë i kënaqur me nivelin e marrëdhënieve, bazuar në respektin e ndërsjellë, dialogun, historinë e përbashkët dhe vlerat kulturore midis dy vendeve tona. Vendet tona bashkëpunojnë edhe në nivelin e Institucioneve Supreme të Auditimit. Në vitet e fundit, ne kemi punuar së bashku dhe organizuar shumë aktivitete për të ndarë njohuritë dhe përvojat. KLSH është një nga partnerët tanë më të rëndësishëm në çështjet ndërkombëtare.

KLSH është një nga SAI-t më aktiv në EUROSAI dhe organizatat të tjera ndërkombëtare. Kryetar i saj është gjithmonë shumë aktiv dhe i interesuar për të kontribuar në shkëmbimin ndërkombëtar. Ai është profesional, i hapur dhe i besueshëm. Si EUROSAI, ne i vlerësojmë shumë kontaktet tona, punët e përbashkëta dhe nxisim vazhdimin e tyre.

Personalisht, Shqipëria zë një vend të rëndësishëm në jetën dhe karrierën time. Dy vite më parë, në prill 2013, unë u dekorova me "Medaljen e Mirënjohjes" nga Shkëlqesia e Tij z. Bujar Nishani, Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Në qershor 2013, Rektori, Prof. Jorgaq Kacani me dha titullin "Honoris Causa" të akorduar nga Senati i Universitetit në një ceremoni të zhvilluar në Universitetin Politeknik të Tiranës. Më duhet ta pranoj që u ndjeva shumë i nderuar me këta tituj.

**Të dashur Kolegë,**

Siç e dini, EUROSAI promovon bashkëpunimin profesional midis vendeve anëtare dhe inkurajon shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave. EUROSAI është një organizatë rajonale nga më aktivet të INTOSAI-t dhe ka marrëdhënie të forta me organizatat e tjera si ASOSAI, OLACEFS dhe ARABOSAI. Bashkëpunimi dhe kooperimi ndërkombëtar na ofron mundësi të shumta për të riparë qasjet tona, metodologjinë, stilin e punës dhe të riformojmë veten tonë në përgjithësi.

Qëllimi i parë strategjik i EUROSAI është ngritja e kapaciteteve për anëtarët e SAI-t. EUROSAI është i angazhuar për të lehtësuar zhvillimin e SAI-ve të fortë, të pavarur dhe shumë profesionale. Në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre me kompetencë dhe profesionalizëm, SAI-et duhet të kenë një kornizë të përditësuar të standardeve profesionale ndërkombëtare. EUROSAI synon të promovojë dhe lehtësojë zbatimin e ISSAI brenda kuadrit të qëllimit të saj të dytë strategjik. Së treti, EUROSAI ka për qëllim përmirësimin e njohurive, informacioneve dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet anëtarëve të saj dhe me partnerët e jashtëm në mënyrë që të forcohet auditimi në sektorit publik, përgjegjshmëria, qeverisja e mirë dhe transparenca në rajonin e saj. EUROSAI ka miratuar si objektiv të katërt "Qeverisjen dhe Komunikimin".

Këto objektiva janë përgjegjësi jo vetëm për EUROSAI-n, por edhe për anëtarët e saj. Arritja e këtyre objektivave është shumë e rëndësishme për të ndihmuar në mënyrë efektive kombin respektiv të çdo SAI. Si anëtarë të EUROSAI, ne duhet të përmirësojmë kapacitetet tona institucionale dhe profesionale, metodat e auditimit dhe standardet, kapacitetin qeverisës dhe komunikimin për ti shërbyer popujve tanë, komunitetit ndërkombëtar madje edhe njerëzimit.

Duke shfrytëzuar këtë mundësi, unë do të doja të japë disa informacione në lidhje me Kongresin e ardhshëm EUROSAI, i cili do të mbahet në Turqi, Ankara, në 2017. Tema e Kongresit është identifikuar si "Zbatimi ISSAI: Sfidat dhe Zgjidhjet".

Të nderuar kolegë, EUROSAI ka kontribuar ndjeshëm në krijimin e ISSAI. Përmes Kongresit, ne do të dëshironim të zbulonim se si po vazhdon zbatimi i standardeve, duke identifikuar sfidat në zbatimin, dhe zgjidhjet për t'u përballur me këto sfida. Ne besojmë se bashkësia e anëtarëve të EUROSAI-t ofron një platformë të shkëlqyer për të diskutuar këto çështje. Ne kemi për qëllim të mësojmë nga praktikat e SAI-ve të cilat kanë një traditë të gjatë në auditim, si dhe nga SAI-t, të cilat janë relativisht të reja, por që kanë përvoja të ndryshme në auditim.

Ky Kongres do të na japi një mundësi të re për të mësuar nga njëri-tjetri. Për të arritur këtë, ne do të marrim kontakt në të ardhmen e afërt me çdo SAI dhe do të kërkojmë mbështetjen tuaj. Prandaj i ftoj të gjithë të kontribuojnë në mënyrë aktive në këtë ngjarje. Së bashku, le të shfrytëzojë momentin, për të përmirësuar praktikat tona të auditimit.

**Të nderuar kolegë,**

**Të nderuar të ftuar,**

Sot, një nga çështjet më të rëndësishme pothuajse për të gjithë kombet është që të forcojë legjitimitetin demokratik dhe llogaridhënien e qeverisë para qytetarëve. Me krizën financiare dhe ekonomike, kjo çështje është bërë më e rëndësishme. Është e qartë se tani është një prioritet i lartë për autoritetet kombëtare dhe institucionet ndërkombëtare përdorimi më i mirë i fondeve publike në dispozicion.

Paralelisht me këtë, sot ka edhe një konsensus global mbi rëndësinë e forcimit të SAI-ve në mbarë botën. Siç e dini, në vitin 2011 dhe 2014, Kombet e Bashkuara miratuan dy rezoluta në promovimin dhe forcimin e SAI-t, si një kusht thelbësor i rendit demokratik. Këto rezoluta nënvizojnë rolin e rëndësishëm të SAI-t në promovimin e përgjegjshmërisë, efektivitetit, efiçencës dhe transparencës së administratës publike.

Siç theksohet nga këto rezoluta, SAI-t luajnë një rol kyç në forcimin e legjitimitetit demokratik dhe llogaridhënien e institucioneve publike. Në demokraci, SAI ka një

rëndësi jetike dhe luan një rol kyç në promovimin e qeverisjes në sektorin publik. Duke përfituar nga ky rast, unë dëshiroj të theksoj shkurtimisht disa nga aspektet më të rëndësishme të SAI-ve.

Së pari, nuk ka dyshim se ato kanë një rol thelbësor në mirëfunksionimin e demokracisë dhe janë një zë në sistemin e menaxhimit publik.

Ato janë institucione kyçe për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies, drejtësisë dhe barazisë, efiçencës dhe efektivitet, respektimin e sundimit të ligjit dhe standardeve të larta të sjelljes etike në menaxhimin publik. Siç e dini, këto parime janë bazat e qeverisjes së mirë.

SAI-t janë përgjegjëse për të ndihmuar në mirë menaxhimin dhe përdorimin me efektivitet të fondeve publike duke pasur parasysh nevojat dhe pritjet e qytetarëve. Si kujdestar i transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik, SAI-t ndihmojë qeveritë në ushtrimin e mbikëqyrjes duke vlerësuar nëse subjektet qeveritare veprojnë ashtu siç kërkohet, shpenzojnë fondet për qëllimet e synuara dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

Arsyet kryesore për ekzistencën e SAI-ve janë për të mbështetur parlamentin, për të ndihmuar qeverinë për të përmirësuar performancën e saj dhe për të siguruar llogaridhënien. Përtej këtyre, ne jemi të vetëdijshëm për faktin se qëllimi i përgjithshëm i një SAI është për të sjellë dobi në jetën e qytetarëve. Dhe, për të promovuar qeverisjen me cilësi të lartë të, me qëllim përmirësimin e jetës për qytetarët, SAI-t duhet të jenë të hapur për pjesëmarrjen e publikut, shoqërisë civile, parlamentit dhe aktorëve të tjerë.

Për më tepër, SAI-t kanë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, e cila përbën një kërcënim të madh për sundimin e ligjit, parimin themelor të demokracisë, dhe për stabilitetin ekonomik. Siç e dini mirë, SAI-t kanë role kyçe në shumë fusha të tilla si zhvillimi i qëndrueshëm, mbrojtja e mjedisit, etj. Duke marrë parasysh rritjen e rolit të SAI-t, prioriteti ynë është për të rritur kapacitetin tonë për të ndihmuar

qeveritë për të përmirësuar qeverisjen demokratike dhe përdorimin efektiv të burimeve publike për të mirën e qytetarëve.

Përforcimi i bashkëpunimit dhe kooperimit midis nesh është një nga mënyrat më efektive për të rritur kapacitetet tona. Unë besoj tek rastet kur shtetet bashkëpunojnë, vendosin besim midis tyre dhe promovojnë paqen dhe prosperitetin në botë. Unë jam gjithashtu i sigurt se, në botën e sotme komplekse dhe në ndryshim të shpejt, bashkëpunimi dhe kooperimi efektiv janë të një rëndësie të madhe në rritjen e kapaciteteve të institucioneve tona, në mënyrë që të ndihmojmë kombet tona për një jetë më të mirë.

Në këtë kontekst, unë dëshiroj të theksoj rëndësinë e përdorimit të platformave të INTOSAI dhe EUROSAI në mënyrë sa më efektive për shkëmbime, dialog dhe bashkëpunim mes të gjitha palëve. Platforma të tilla kontribuojnë në përpjekjet tona për të nxitur më tej qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në vendet tona dhe në të gjithë botën.

**I dashur President dhe kolegë të KLSH,**

Si Gjykatë Turke e Llogarive, ne jemi gjithmonë të gatshëm për të punuar së bashku me ju. Me 90 vjet përvojë, ju përfaqësoni harmoninë midis traditës dhe progresit. Gjykata Turke e Llogarive, me historinë e saj përfshin më shumë se 150 vjet, ka një perspektivë të pasur, përvoja dhe njohuri të shumta. Siç theksohet dhe në moton INTOSAI-t, "Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë". Ju të gjithë jeni të vetëdijshëm se, në vitet e fundit, ne kemi mësuar nga njëri-tjetri dhe jemi tërhequr nga forca e njëri-tjetrit. Në vitin 2012, ne kemi nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për të rritur bashkëpunimin ndërmjet institucioneve tona. Që atëherë, ne kemi organizuar shumë aktivitete bashkëpunuese për të shkëmbyer njohuritë dhe përvojat dhe për të përmirësuar kapacitetet tona profesionale dhe institucionale. Natyrisht, vizioni dhe personaliteti i shquar i Kryetarit Leskaj i shton vlera më shumë bashkëpunimit tonë të jashtëzakonshëm. Unë gjithashtu kam dëshmuar personalisht kontributin e tij të shquar dhe përpjekjet për zhvillimin e mëtejshëm të KLSH-së, në pothuajse të gjitha fushat. Është besimi im i sinqertë se KLSH do të vazhdojë

përparimin e saj nën drejtimin e tij dhe partneriteti ndërmjet institucioneve tona do të forcohet edhe më tej në vitet që vijnë.

Me këtë rast, dua të theksoj vlerën e rritjes së partneritetit mes dy vendeve tona, Shqipërisë dhe Turqisë, duke theksuar se populli turk është i angazhuar fort për suksesin e këtij partneriteti.

Së fundi, unë duhet të shpreh falënderimet e mia të veçanta për mikpritjen tuaj dhe mikpritjen e popullit të Shqipërisë.

Në emër të EUROSAI-t dhe TCA, unë do të doja të përgëzoja KLSH-në edhe një herë, me rastin e përvjetorit të saj të 90-të, duke i uruar gjithë të mirat për të ardhmen!

***Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!***


1925-2015
90 Vjet KLSH
90 YEARS
ALSAI



## Përshëndetje nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, z. Bashkim Dedja




*I nderuar z. Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,*

*Të nderuar kolegë e pjesëmarrës,*

Është nder dhe kënaqësi që të marr pjesë në këtë aktivitet të 90 - vjetorit të krijimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Përshëndes organizatorët e kësaj ceremonie, që ndërmarrin iniciativa të këtij lloji më se të nevojshme në aktualitetin shqiptar, ku aktorët kombëtarë shtetërorë dhe ndërkombëtarë të ftuar sikundër konstatoj, mund të përçojnë mendime apo qëndrime mbi koncepte me interes të gjerë, si vazhdimësia dhe forcimi i institucioneve të pavarura kushtetuese, ku bën pjesë dhe KLSH, në funksion të shtetit të së drejtës, si dhe më specifikisht eficenca dhe efektiviteti i përdorimit të fondeve publike, promovimi i integritetit të veprimtarisë së administratës publike si fokusi kryesor i veprimtarisë kontrolluese të KLSH, si mekanizëm kushtetues i kontrollit mbi mirëqeverisjen e fondeve publike.

Duke qenë se në këtë ceremoni jam i ftuar në pozicionin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, po përmend shkurtimisht jurisprudencën kushtetuese të kësaj gjykate në lidhje me KLSH-në. Disa prej çështjeve të gjykuara nga Gjykata Kushtetuese kanë pasur të bëjnë me organizimin e këtij institucioni, dhe më konkretisht me mandatin e Kryetarit të KLSH-së, me shtrirjen e ushtrimit të kompetencave të tij si në rastin e kontrollit ndaj partive politike, si dhe me kuptimin e gjendjes juridike të tij si organ i pavarur.

Në gjykimin me objekt dispozita të ligjit që përcaktonin çështjet të mandatit të Kryetarit të KLSH, sipas Gjykatës Kushtetuese: *"....mbrojtjen e pavarësisë në kryerjen e detyrave për disa organe kushtetuese, Kushtetuta e shikon tek nënshtrimi vetëm ndaj saj e ligjeve, ndërsa garancitë për palëvizshmërinë në detyrë si element të pavarësisë, Kushtetuta i sheh jo vetëm tek përcaktimi i rasteve për shkarkim dhe rasteve për mbarimin para kohe të mandatit, por edhe tek mjetet e tjera juridike e kushtetuese siç janë: miratimi i ligjeve për organizimin e funksionimin e institucioneve me një shumicë të cilësuar prej 3/5 të deputetëve, përcaktimi i kuorumit të nevojshëm për nismën për shkarkim si dhe kuorumit të nevojshëm për miratimin e shkarkimit të tyre. (...) Pavarësia e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të kuptohet si pavarësi absolute pa lidhje e ndërvarësi nga organet e tjera.* (*Vendimi nr. 212/2002* ).

Nga këndvështrimi i ushtrimit të juridiksionit kushtetues, Gjykata Kushtetuese, ka pasur raste të gjykojë çështje të kontrollit abstrakt të normës, ku KLSH ka qenë vetë në cilësinë e kërkuesit. Në një vendim, në të cilin asaj iu kërkua nga Avokati i Popullit dhe KLSH që të shfuqizonte si të papajtueshëm me Kushtetutën, disa nene të Ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj" për sa ato përfshijnë edhe institucionet e pavarura kushtetuese, u shpreh se: . . . *ligjet organike zbërthejnë më tej dhe konkretizojnë më qartë dhe më mirë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese që garantojnë sipas rastit dispozita të veçanta të Kushtetutës. (...) duhet vënë në dukje se pavarësia e tyre e garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet organike përkatëse, ka si përbërës apo elementë të qenësishëm të saj pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe pavarësinë financiare. ( Vendimi nr.19/2007).*

KLSH kontrollon administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Në këtë mënyrë pra funksionon si një prej institucioneve që realizon kontrollin administrativ të specializuar të administratës publike nga këndvështrimi ekonomiko-financiar. Në drejtim të kësaj kompetence, para Gjykatës Kushtetuese u shtrua për zgjidhje pyetja nëse KLSH mund të kontrollojë edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera nga partitë politike. Gjykata Kushtetuese konkludoi se: *… ndihmat dhe dhuratat që partitë politike përfitojnë nga donatorë të ligjshëm dhe që nuk kanë të bëjnë me fondet publike, të analizuara edhe në këtë aspekt, dalin jashtë objektit të këtij kontrolli të specializuar.* Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese arsyetoi edhe se gjithsesi partitë politike nuk e kanë të pakontrollueshme veprimtarinë e tyre ekonomiko-financiare, sepse neni 9/3 i Kushtetutës i detyron ato që burimet financiare dhe shpenzimet e tyre t'i bëjnë kurdoherë publike (*Vendimi nr.33/2001*).

Së fundmi, do të theksoj se pa dyshim që një punë profesionale, eficente dhe e përgjegjshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit dikton një menaxhim më të mirë të fondeve publike dhe për rrjedhojë të interesit publik në vend, gjë për të cilën jemi të interesuar të gjithë, si qytetarë dhe funksionarë publikë.

***Duke ju uruar suksese në punën tuaj të mëtejshme, Ju falënderoj për vëmendjen!***



**Fjala përshëndetëse e Akademik Anastas Angjeli,**

**në emër të Akademisë së Shkencave**



I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Leskaj,

I nderuar ish Presidenti i Republikës , z.Topi,

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z.Meta,

I nderuar President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Caldeira,

I nderuar Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës Austriake të Auditimit, z. Moser,

I nderuar z. Dedja, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,

Të nderuar Ambasadorë,

Të nderuar kolegë, profesorë, ekspertë, deputetë, miq dhe të ftuar,

Për mua është kënaqësi e veçantë, që në emër të Akademisë së Shkencave dhe jo vetëm, por edhe si akademik dhe profesor për vite të tëra me fushën e financave publike dhe atë të auditimit, por dhe në të njëjtën kohë dhe si një ish funksionar i lartë shtetëror dhe deputet, i angazhuar me këto çështje, të përshëndes KLSH për këtë ngjarje të veçantë. Njëkohësisht, e konsideroj një vlerësim që jam sot në këtë ceremoni me rastin e 90 vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me gjithë fillesat e hershme në vendin tonë, u krijua si institucion kushtetues 90 vite më parë dhe vetëm 13 vite pas lindjes së shtetit shqiptar. Në këtë rrugëtim 90 vjeçar ai ka pësuar evoluimin e tij si institucion, evoluimin ligjor, profesional dhe ka një kontribut të qenësishëm në mirëqeverisjen e vendit dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet veprimtarisë së tij audituese ka synuar dhe synon në mënyrë të vazhdueshme përdorimin me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e publikut dhe Kuvendit të Shqipërisë. Ky institucion me përgjegjësi të madhe, ka nxitur dhe forcuar përgjegjshmërinë në menaxhimin e financave publike, transparencën për përdorimin e tyre dhe ka kontribuar në llogaridhënien e institucioneve të ekzekutivit.

Ndryshimi i bazës ligjore mbi të cilën e ushtron veprimtarinë KLSH, përafrimi i tij me legjislacionin e vendeve të BE dhe përfshirja në të e auditimeve të Performancës dhe Teknologjisë së Informacionit, e bën të domosdoshëm zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit me rrethet akademike dhe universitetet, të cilat me ekspertizën e tyre ndihmojnë në vendosjen e punës audituese mbi baza shkencore, kryerjen e auditimeve cilësore dhe dhënien e rekomandimeve që i shërbejnë një qeverisjeje më të mirë.

Në këtë kuadër është për t'u vlerësuar iniciativa e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Leskaj për organizimin e 3 konferencave shkencore, në të cilat mendimi akademik luajti një rol thelbësor.

Referuar situatës ekonomike me të cilën përballet Shqipëria dhe problematikave të trajtuara në këto konferenca, është e rëndësishme të theksohet se KLSH duhet të fokusohet në auditimet mbi menaxhimin e borxhit publik, zbatimin e politikës financiare të qeverisë dhe politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Për këtë nevojitet mbikëqyrja e rritur e KLSH mbi veprimtarinë rregulluese financiare në bashkëpunim me parlamentin, shoqërinë civile dhe mediat.

Publikimet, debatet dhe mendimet e akademikëve dhe pedagogëve të njohur në fushën e ekonomisë, dhe veçanërisht të auditimit, të jurisprudencës janë gjithashtu pjesë e rëndësishme e një reviste shkencore të KLSH "Auditimi Publik", por njëherësh një shtysë përpara e mendimit shkencor në këtë fushë. Ato kanë qenë pjesë e debatit pozitiv për konsolidimin e reformave të ndërmarra nga KLSH.

Përmirësimi i dukshëm i punës audituese, shtrirja e auditimit në performancë, në IT dhe shtimi i numrit të auditimeve të KLSH është arritur gjithashtu edhe falë hapjes që ky institucion ka për bashkëpunimin me institucionet e tjera, me ekspertë të jashtëm, të cilët kanë kontribuar në kryerjen e auditimeve cilësore. Kjo sepse sfidat e KLSH për modernizimin dhe rritjen e efikasitetit të punës se tij nuk mund të arrihen pa një bashkëpunim të gjerë, shumë dimensional, institucional, akademik, shkencor dhe profesional.

Objektivat e Kontrollit të Lartë të Shtetit për modernizimin e Institucionit, të pasqyruara me ambicie në Planin Strategjik afatgjatë pa dyshim mund të realizohen vetëm nëpërmjet një stafi të mirë shkolluar dhe të mirë kualifikuar. Për këtë KLSH në bashkëpunim me universitetet e ndryshme në vend duhet të intensifikojnë përpjekjet për futjen në kurikulat pasuniversitare të temave që lidhen drejtpërdrejtë me auditimin e jashtëm publik dhe njohjen e standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Në përfundim më lejoni të konfirmoj, bindjen time, se Kontrolli i Lartë i Shtetit është një institucion në konsolidim të vazhdueshëm dhe reformat e ndërmarra gjatë viteve të fundit kanë hedhur themelet e një institucioni modern dhe transparent ndaj publikut, i cili e bazon veprimtarinë e tij tërësisht në standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në eksperiencat më të mira të institucioneve homologe.

Unë dua t`ju siguroj se në këtë rrugë të konsolidimit të reformave të këtij institucioni, mbështetja e Kuvendit dhe në veçanti e qarqeve akademike do të jetë domethënëse, çka do ta ndihmojë më tej KLSH në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për një qeverisje më të mirë të vendit, në luftë kundër korrupsionit dhe për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

**Faleminderit dhe Suksese!**

*Foto gjatë fjalës përshëndetëse të Akademikut Anastas Angjeli,*

*në emër të Akademisë së Shkencave*



## Përshëndetje nga Prof. Dr. Jorgji Bollano

*(Në emër të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit)*



I nderuar Z.Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

Të nderuar pjesëmarrës në këtë sallë,

Është kënaqësi e veçantë që marr pjesë në këtë event të 90 vjetorit të KLSH-së dhe e falënderoj kryetarin z. Leskaj për këtë ftesë.

Është meritë e veçantë e Kryetarit të këtij institucioni që di të vlerësojë punën e bërë dhe çka është me e rëndësishme di dhe ta promovoje atë.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit që unë përfaqësoj, ka për funksion hartimin e standardeve të kontabilitetit që ndihmojnë në raportimet financiare. Ne kemi patur një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe këtë e kemi ligjëruar me një marrëveshje të përbashkët. Meqenëse të dy institucionet si KLSH dhe KKK kontrollojnë dhe ndihmojnë njeri tjetrin duke qenë se kanë subjekte të përbashkëta që kontrollojnë, shoqëritë me fonde publike. Për të theksuar është bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe të kontrollit të cilësisë se auditimit. Ne kemi qenë bashkëpunues në të gjitha Konferencat e organizuara nga KLSH, si dhe në fushën e botimit të tij.

Ne, si Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit kemi siguruar rregullimet kontabël në njësitë ekonomike, bazuar në standardet e kontabilitetit, çka është një bazë shumë e fuqishme për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë së këtyre njësive. Jemi në përfundim të standardit kontabël për organizatat jofitimprurëse, çka bën të mundur kontrollin e veprimtarisë së tyre.

Duke përfunduar i uroj Kontrollit të Lartë të Shtetit suksese në punën e tij, për kontrollin e qeverisjes së financave publike dhe njëkohësisht bashkëpunim të mëtejshëm me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit.

***Ju faleminderit!***



## Përshëndetje nga z. Bashkim Spahija

*(31 vjet auditues në KLSH)*



I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

I nderuar z.Moser,

I nderuar z.Caldeira,

I nderuar zoti Leskaj,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Falënderoj Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotin Bujar Leskaj për ftesën që më bëri për të marrë pjesë në këtë eveniment të rëndësishëm të organizuar me rastin e 90 vjetorit të institucionit, në të cilin unë punova për rreth 31 vjet, pra gjatë 1/3 të jetës së institucionit, deri sa dola në pension në vitin 2013.

Gjatë këtyre 31 viteve në këtë institucion, mendoj që kam punuar me përkushtim e ndershmëri për realizimin e detyrave të ngarkuara, duke dhënë kontributin tim modest në mbarëvajtjen e auditimit në fushën e të ardhurave e shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe administrimit të pronës shtetërore, duke e konsideruar besim publik funksionin tim si punonjës i këtij institucioni.

Bazuar në historikun e KLSH-së që nga krijimi e deri më sot, veprimtaria e këtij institucioni është mbështetur në dispozitat ligjore e nën ligjore sipas periudhave, ku përgjithësisht ka qenë në vartësi e në përbërje të organeve ekzekutive.

Pavarësisht emrit dhe mënyrës së organizimit dhe vartësisë, karakteri kontrollues apo si inspektor financiar i shtetit mbeti i njëjtë. Suksesin më të madh ky organ e arriti me ndryshimet demokratike pas viteve 1990, ku përfundimisht kemi të bëjmë me një organ kushtetues të pavarur, i depolitizuar e departizuar që vepron në bazë të kushtetutës dhe ligjit të tij organik. Kjo shënoi dhe përpjekjet e para për ta sjellë këtë institucion në nivele më të përparuara duke krijuar kushtet bazë që auditimi të realizoje objektivat dhe te funksionoje sipas Standardeve.

Marrja nga ana e Shqipërisë e statusit të vendit kandidat dhe rruga për anëtarësim të plotë në BE, vendos detyra e përgjegjësi te reja edhe për KLSH-në, për të cilat po punohet për ta kthyer në institucion modern duke u bazuar në eksperiencat më të mira të vendeve të BE-së dhe duke zbatuar standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t. Këto standarde po implementohen me këmbënguljen e vazhdueshme të stafit drejtues të KLSH-së dhe miratimi i ligjit të ri të KLSH-së, "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", do të ndihmojë në përmbushjen e këtyre detyrimeve sepse ky ligj është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Objektivat për modernizimin e institucionit të paraqitura nga zoti Bujar Leskaj në komisionin e ekonomisë me rastin e emërimit për pozicionin e kryetarit të KLSH-së në dhjetor të vitit 2011, i kanë shërbyer këtij qëllimi. Zhvillimet gjatë tre viteve të fundit kanë treguar që ato objektiva janë realizuar dhe po perfeksionohen vazhdimisht, dhe janë dëshmi se këto objektiva nuk i ngjajnë premtimeve elektorale, por janë dhe mbeten objektiva reale e të prekshme, të cilat janë pasqyruar dhe në analizat periodike të veprimtarisë, në tre konferencat shkencore të viteve të fundit të KLSH, në botimet e KLSH dhe në media, të cilat do të ishte e pamundur ti përmendja këtu dhe për efekt të kohës në dispozicion.

Rritjen e autoritetit të KLSH në këtë periudhë pune intensive tre vjeçare e tregon më së miri në mënyrë domethënëse dhe vendi ku po zhvillohet ky eveniment që tregon njëkohësisht dhe rritjen e bashkëpunimit me Kuvendin e Qeverinë për arritjen e një misioni të përbashkët, atë të maksimalizimit të kontributeve të dhëna në drejtim të mirëqeverisjes së vendit.

Mendoj që stafi i KLSH-së dhe Kryetari i tij e kanë të ligjshme për t'u ndjerë krenarë për punën e bërë në këtë periudhë për mirëqeverisjen e vendit. Megjithatë, mendoj se mbështetja nga institucionet e audituara është tepër e rëndësishme për të realizuar me sukses misionin e auiditimit. Në ketë aspekt mendoj që ekzekutivi të tregohet më i vëmendshëm ndaj rekomandimeve të KLSH-së, duke i vlerësuar, shqyrtuar e analizuar qoftë dhe duke i kundërshtuar në mënyrë të arsyetuar me qëllim zbatimin e plotë të tyre dhe të sjellin përmirësime në administrimin e fondeve publike. Po kështu edhe Prokuroria brenda afateve ligjore të vlerësojë dhe të hetojë kallëzimet penale të paraqitura nga KLSH-ja, pasi duke punuar se bashku do të luftohet më mirë korrupsioni.

Duke përfunduar, stafit drejtues dhe të gjithë punonjësve të KLSH-së u uroj punë të mbarë e suksese në zbatimin e detyrave kushtetuese e ligjore!



*(Nga e majta në të djathtë): Ish Drejtori i Përgjithshëm i KLSH-së z. Robert Gjini, ish Kryetarët e KLSH-së, z. Ylli Memisha, z. Stefan Papagjoni, z. Mustafa Kërçuku, z. Robert Çeku, si dhe ish Prokurori i Përgjithshëm z. Theodhori Sollaku.*

## HISTORIKU DHE VEPRIMTARIA E KLSH-SË NË 90 VJET

*Nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj (fjala e mbylljes)*



**Të nderuar zonja dhe zotërinj,**

Në cilësinë e Kryetarit aktual të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kam privilegjin, por edhe krenarinë njëkohësisht, që të përshëndes në emër të gjithë atyre punonjësve dhe drejtuesve që kanë punuar me ndershmëri, përkushtim e pasion, duke dhënë një kontribut të vyer për këtë institucion, përgjatë këtyre 90 viteve.

Ne e organizuam këtë takim, të frymëzuar nga vetëdija jonë kombëtare se kujtesa historike dhe respektimi i vlerave dhe kontributit të të gjithë brezave, duhet të jetë pjesë e pandarë e kulturës dhe trashëgimisë sonë institucionale. Të kërkosh identitetin institucional nëpërmjet hedhjes dritë dhe evidentimit të historisë së zhvillimit është mbi të gjitha përgjegjësi, por edhe një shërbim për gjeneratat e ardhshme.

Më lejoni të jap një vështrim të shkurtër të tipologjive, objektit dhe emërtesës institucionale në 90 vjet të ekzistencës të KLSH-së në Shqipëri.

Nga një hulumtim i historisë 90 vjeçare të KLSH-së, mund të konfirmohet se institucioni në mënyrë të pashmangshme, në evoluimin e tij ka ndjekur pashmangshmërisht progresin shoqëror, regresin, në raste të caktuara dhe transformimet social-politike, ekonomike e diplomatike të Shqipërisë, që nga themelimi i shtetit modern dhe deri në ditët e sotme.

Ky institucion, i cili daton në 1925, ka funksionuar gjatë gjithë kohës, pas miratimit të statutit të Republikës, përgjatë Monarkisë Kushtetuese, përgjatë regjimit komunist diktatorial e vazhdon në ditët tona, duke ju përshtatur rrethanave historike, me rregullime të caktuara të kompetencave dhe të objektit të veprimtarisë, tipit të kontrollit, emërtesës dhe të tjera.

Ishte themeluesi i shtetit shqiptar Ismail Qemal Vlora, që kreu aktin më të lartë në të gjithë historinë institucionale te Shqipërisë, themeloi shtetin modern shqiptar dhe përmes një sërë vendimesh politike e diplomatike, vendosi gurët e themelit të tij. Ai ngriti flamurin e Pavarësisë në Vlorë, më 28 Nëntor të vitit 1912, shpalli Shqipërinë shtet të pavarur, punoi për njohjen e saj nga fuqitë ndërkombëtare dhe njëherazi filloi inicimin e krijimit të institucioneve në Shqipëri. Në politikën dhe veprimtarinë ekonomike të Qeverisë së Ismail Qemal Vlorës, pa dyshim një vend të rëndësishëm do të zinte problemi financiar. Ismail Qemali deklaroi vendimet e para dhe të nevojshme që duhet të merrte kombi shqiptar, një ndër të cilat ishte “Të zgjidhet një pleqësi për ndihmë e kontroll të qeverisë”. Ndonëse për kohën e shkurtër të veprimit të kësaj Qeverie, nuk u organizuan institucione të veçanta të njehsuara e të specializuara të kontrollit, mund të konfirmohet se në këtë periudhë shihet një

mpiksje e funksioneve të kontrollit me funksionet e administrimit dhe menaxhimit financiar.

Administrimi i kontrollit financiar ne vitet 1920-1924, u sanksionua nëpërmjet Statutit të Zgjeruar të Lushnjës, i cili ngarkonte Këshillin Kontrollues të Financave me kontrollin e financave të shtetit.

Në Qeverinë e Fan.S.Nolit, me gjithë kohën e shkurtër të qeverisjes dhe kushteve mjaft të vështira ekonomike, politike dhe financiare, roli i Komisionit Kontrollues të Financave u orientua nga skema e kontrollit të llogarive të financave .

Nën qeverisjen e Ahmet Zogut, si Kryetar i Republikës dhe me tej Mbret i Shqipërisë, Institucioni i Kontrollit më të lartë në vend shfaqet si Institucioni i Këshillit Kontrollues, dhe u dekretua me dekretin e 20 Majit 1925, i cili hyri në fuqi më 26 Maj 1925, ditë të cilën po e përkujtojmë dhe ne sot. Institucion i Këshillit Kontrollues kishte në boshtin e veprimtarisë së tij kontrollin e financave të shtetit dhe gëzonte atributet e një organizmi të pavarur pranë Parlamentit. Janë shumë interesante diskutimet në ato vite, nga deputetët e parlamentit të kohës për strukturën, për mënyrën e organizimit dhe për ligjin, deri sa u arrit në ligjin që u miratua, apo në debatet e mëtejshme. Në botimin tonë modest “Historiku i KLSH 1920-2013” që ne kemi botuar para dy vitesh, ju gjeni shumë të dhëna në lidhje me këto.

Në periudhën e pasluftës së Dytë Botërore, nën komunizmin, natyrisht Këshilli Kontrollues i Financave kaloi në regres, iu nënshtrua një sërë riorganizimesh të njëpasnjëshme, duke humbur pavarësinë (strukturë nën varësinë e ekzekutivit dhe të partisë-shtet), në shërbim të politikës së shtetit totalitar.

Metamorfoza e institucionit filloi me shfuqizimin e Dekret-ligjit të vitit 1925, për Këshillin Kontrollues, përmes Ligjit nr. 277, datë 14.8.1946, i cili krijonte Kontrollin e Përgjithshëm të Shtetit, strukturë krejtësisht e varur nga partia-shtet.

Deri në fund të vitit 1990, Kontrolli Shtetëror, si pjesë e strukturës së pushtetit ekzekutiv, duke qenë në vartësi të drejtpërdrejtë të Qeverisë, kishte mungesë të plotë pavarësie, pavarësisht se duhet të theksojmë se në gjithë këto vite, rreth 45 vite në këtë institucion kanë qenë dhe shumë punonjës të aftë dhe kontrollues të

përkushtuar e të devotshëm, të mbrujtur me parimet më të mira të financave dhe kontrollit të financave publike.

Me ardhjen e Demokracisë, zhvillimet pozitive u reflektuan dhe në fushën e auditimit të jashtëm publik. Me asistencën e Nismës Ligjore për Evropën Qendrore dhe Lindore (CEELI - Central and East European Initiative), një projekt ky i Qeverisë Amerikane, u ripunua dhe u paraqit projekt/ligji "Për Shërbimin e Kontrollit të Shtetit", i cili u miratua nga Kuvendi në fund të muajit gusht 1992.

Me miratimin e këtij ligji, tashmë për kontrollin shtetëror u hodhën themelet e një organi dhe organizimi të ri, të ndryshëm në formë dhe përmbajtje, nga funksionet dhe struktura e organizmave të mëparshme. Pavarësia e këtij organi nga Qeveria u sanksionua me dispozitat kryesore kushtetuese dhe ligjin organik të lartpërmendur. U ndërtua një strukturë e re e organeve të kontrollit, në përshtatje me rolin e ri që merrte ky institucion në shtet ligjor që po krijohej dhe u krijua në Shqipëri.

Në kuadër të proceseve integruese, gjatë viteve 1996–1997, ekspertët e SIGMA-s në bashkëpunim me drejtuesit e asaj kohe të KLSH-së, ndërmorën disa hapa serioze për modernizimin e kontrollit të jashtëm në Shqipëri, duke kërkuar përafrimin e legjislacionit sa më shumë me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Pavarësia e plotë, po themi e institucionit, depolitizimi dhe departizimi i organit suprem të kontrollit u arrit me miratimin e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" dhe më pas u sanksionua edhe në dokumentin themeltar të Shtetit në "Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", pjesa e katërmbëdhjetë "Kontrolli Lartë i Shtetit", në të cilën nenet 162-165 i kushtohen tërësisht KLSH.

Këto akte mundësuan rikthimin e pavarësisë funksionale organizative, operacionale të institucionit dhe depolitizimin e tij. KLSH operoi përgjatë viteve 1998-2006, duke gëzuar pavarësi dhe duke u përpjekur të bashkëpunonte dhe më tej me institucionet homologe dhe partnerët ndërkombëtarë.

Me ndihmën e ekspertëve të SIGMA-s dhe të projektit të binjakëzimit CARDS 2007, KLSH paraqiti Strategjinë e Zhvillimit 2007-2011, dhe u punua gjerësisht për ta implementuar këtë.

Gjatë këtij pasazhi të shkurtër të historisë së zhvillimit të Institucionit të KLSH-së, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, që në emër të vlerësimit qytetar, të shprehim nderimet tona për personalitetet dhe audituesit e ndershëm që kanë drejtuar këtë institucion apo kanë punuar në këtë institucion, për vite me radhë.

Në pamundësi të përmendjes së të gjithë figurave të drejtuesve, të cilët janë të shumtë në numër do të veçoja personalitetet e ndritura, veçanërisht në vitet 1925 - 1944 si Kol Thaçi, Lac Gera, Llambi Aleksi, Fejzi Alizoti, Lame Kareco, Eqerem Libohova, Xhaferr Ypi, Rrok Gera, Izedin Beshiri dhe të tjerë.

Më lejoni në këtë përkujtim të 90-të të KLSH-së, të vlerësoj punën reformuese të Kryetarëve të KLSH-së të viteve 90 dhe pas viteve 90, vitet e demokracisë, Ylli Memisha, Stefan Papagjoni, Blerim Çela, Mustafa Kërçuku dhe Robert Çeku.

Gjithashtu përfitoj nga ky rast të vlerësoj në këtë ceremoni në emër të gjithë audituesve të KLSH rolin e madh dhe mbështetjen që na kanë dhënë Presidentët e kohës Prof. Dr. Sali Berisha, Alfred Moisiu, Rexhep Mejdani, Prof. Dr. Bamir Topi dhe Presidentin Bujar Nishani. Me këtë rast, do të doja të shprehja konsiderata, respekt dhe vlerësim maksimal për të gjithë trupën e kontrollorëve, audituesve dhe punonjësve mbështetës të devotshëm, me integritet, punëtorë, korrektë dhe profesionalë, që kanë kontribuar në këtë institucion gjatë gjithë kësaj periudhe 90 vjeçare, dhe jo rastësisht në këtë ditë simbol, ne për ta moderuar aktivitetin zgjodhëm një auditues, i cili mbetet simbol në institucionin tonë, zotin Bashkim Spahija, që i ka kushtuar 30 vjet nga jeta e tij punës në institucionin e KLSH-së.

Këtu vjen pjesa që unë do të shkurtoj, sepse grupi i punës ka bërë një gabim, siç e kemi ne shqiptaret, gjysma e materialit është për historikun e KLSH në 90 vjet dhe gjysma për reformimin e KLSH 2012-2015. Natyrisht nuk është etike dhe nuk është e ndershme, unë këtë pjesë po e kaloj por në këmbim të kësaj kam një përshëndetje tërësisht personale, si Bujar Leskaj.

Unë përfitoj nga ky rast në këtë ceremoni ti shpreh mirënjohjen time të thellë dhe respektin për vlerësimin që më kanë bërë Presidentit Bamir Topi që me dekretoi në nëntor të vitit 2011, presidentin e Kryeministrin e Shqipërisë Porf.Dr. Sali Berisha që më mbështeti tërësisht dhe orientoi grupin e maxhorancës që votuan Dekretin e Presidenti dhe Presidentin aktual Bujar Nishani për krejt ndihmën, mbështetjen, vlerësimet që ka dhënë për KLSH, për homologët tanë, për Kryetarin e KLSH dhe më gjerë.

Një falënderim të veçantë unë kam për ju përfaqësues të nderuar të shoqërisë civile, të profesoratit, të institucioneve të pavarura për këtë ndihmë që keni dhënë në institucionin tonë, për këtë bashkëpunim permanent, i cili jam i bindur do të këtë vazhdimësi në të ardhmen.

Ne, këtë ceremoni nuk e organizojmë për të deklamuar arritjet tona, pasi ne jemi të ndërgjegjshëm që populli shqiptar, publiku, taksa paguesit shqiptarë presin shumë nga ne. Asnjëherë një Institucion Suprem Auditimi, në botë, në Europë, në veçanti në vende si Shqipëria nuk mund të thotë dhe të deklarojë vetëm suksese, suksese. Ne kemi shumë për të bërë dhe jo më kot, ne kemi dy vjet që veprimtarinë tonë e kemi orientuar drejt INTOSAINT-it, që është një metodë që përdoret në komunitetin INTOSAI, drejt vetëvlerësimit të integritetit, të bindur që vetëm duke qenë të paanshëm, objektiv, me integritet, të përgjegjshëm, profesionistë, ne do të realizojmë sfidat që na shtron koha.

Sfidat tona janë ravijëzuar në Planin Strategjik aktual të institucionit 2013-2017, i cili mbështetet tërësisht në katër kolonat e Plani Strategjik të INTOSAI-t dhe kolonat e planit Strategjik të EUROSAI-t, 2011-2017.

Njëkohësisht në këtë forum, unë dëshiroj të shpreh falënderimet e mia për të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, në veçanti të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për ndihmën dhe mbështetjen që na dhanë gjatë procesit të miratimit të Ligjit të ri të KLSH. Pavarësisht pengesave që kishim nga segmente të caktuara, për hir të së vërtetës duhet thënë se ky është një ligj për të cilin ne kemi kaluar një kalvar të gjatë, një vit ligj ishte besoj shumë.

Një falenderim vjen dhe për përfaqësuesit e DG- Budget, SIGMA-s dhe gjithë homologët tanë për ndihmën që na dhanë në kalimin e këtij Ligji. Tashmë ne kemi zbatuar atë orientim, atë kërkesë të Progres-Raporteve të BE-së, e theksuar në vitet 2010, 2011, 2012 e me radhë, që puna, veprimtaria e KLSH të mbështetet mbi një ligj, i cili është i orientuar tërësisht drejt standardeve të auditimit INTOSAI. Këtu është sfida jonë e vërtetë, është sfida jonë për të ardhmen, që doli edhe në kumtesat e diskutantëve, në veçanti të personaliteteve të auditimit të jashtëm publik Europian.

Ne do të vijojmë në të ardhmen të zbatojmë me korrektësi planin e veprimit të strategjisë sonë institucionale, do të vazhdojmë të zbatojmë me përgjegjësi rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë, për të pasur një vijimësi në ecurinë e reformave të ndërmarra deri më tani duke shprehur bindjen se i gjìthë ky proces do të shoqërohet me rezultate konkrete në përmirësimin e qeverisjes kombëtare, në sinergji dhe në bashkëpunim të plotë me qytetarët, me shoqërinë civile, me Kuvendin e Shqipërisë dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë. Ne kemi përgatitur shumë botime, disa materiale që japin të dhëna, sidomos tregues të dobisë së institucionit, numri i kallëzimeve penale, masat e ndryshme të ndërmarra, auditimet e ndërmarra. Orientimi ynë tashmë në këto vite drejt auditimeve të performancës është një sfidë tjetër, në të cilën institucionet Europiane simotra kanë ecur me kohë. Megjithatë unë kam besim në aftësitë, në integritetin, në përkushtimin e pjesës me të madhe të stafit të KLSH-së. Kam besimin e madh që shoqëria civile, ambientet akademike, shoqatat profesionale të fushës, do të vazhdojnë të na mbështesin. Pa dyshim edhe Kuvendi besoj do të na mbështesë, të ndërgjegjshëm për pavarësinë tonë institucionale, pavarësi të cilën e garanton Deklarata e Limës e viti 1977, që është dokumenti themeltar, e garanton specifikisht Deklarata e Meksikos e INTOSAI-t e vitit 2007, e garanton Ligji i ri, e garanton shoqëria jonë civile, e garantojnë të gjithë partnerët tanë të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t. Jo rastësisht përshëndetjet kryesore në ketë ceremoni ishin nga personalitete drejtues të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t dhe të Gjykatës Europiane të Audituesve.

***Unë i falënderoj për këtë!***

Më lejoni ta mbyll këtë ceremoni duke ju uruar të gjithëve partnerëve tanë vendas e ndërkombëtarë, si dhe gjithë audituesve të KLSH-së, 90 vjetorin e Institucionit. Suksese dhe mbarësi në të ardhmen. Duke ju uruar dhe falënderuar, ju i nderuar President, të nderuar deputetë, drejtues të institucioneve të pavarura, drejtues të lartë të Klerit, për kohën dhe vëmendjen që na kushtuat.

Ceremonia jonë do të vazhdojë me një vizitë në Galerinë e Arteve  dhe një koktej modest, shoqëruar nga dy grupe artistike.

U ftoj në dalje për të bërë një foto me të gjithë pjesëmarrësit, siç është tradita më e mirë e institucioneve tona.

Botimet që ju keni përpara jush, kush dëshiron mund ti marrë. Disa botime janë shumë specifike, janë interesante. Natyrisht dhe për të tjerat, ne jemi të hapur në institucionin tonë.

Ju faleminderit dhe dua t'ju theksoj një gjë të fundit, "last but not least". E theksova pak edhe në fjalën hyrëse, por ndoshta duhet të kisha dhe pak emocione. Qëllimi kryesor për kremtimin e 90 vjetorit ishte kthimi drejt kujtesës institucionale, çka e kanë detyrim të gjithë institucionet shqiptare, por ishte dhe si një provë gjenerale po themi, për 100 vjetorin e KLSH-së.

Natyrisht, në rast se kryetari i ardhshëm do të jetë ndonjë burrë i mirë dhe të më ftojë, siç ftova unë homologët e mi, do të vij e do të ulem andej nga fundi, për arsye se as nuk aspiroj, as nuk kërkoj mandat të dytë (do Zoti të mbaroj me sukses mandatin e parë), sepse kam mendimin që mandatet e dyta në këto institucione të pavarura dhe në veçanti mandatet e dyta në institucionet supreme të auditimit, e cënojnë funksionimin e mirë të institucionit. Në rast se do të kërkosh mandatin e dytë, duhet që gjysmën e mandatit të parë ta harxhosh duke iu servilosur politikanëve. Unë nuk kam ndër mend ta bëj këtë!

***Ju faleminderit dhe gjithë të mirat!***





**Presidenti Nishani vlerëson me Titullin "Për Merita të Veçanta Civile" Presidentin e Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Vitor Caldeira dhe Kryetarin e KLSH-së, z. Bujar Leskaj**

Me rastin e 90-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në datën 25 maj 2015, Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Bujar Nishani i akordoi, në një ceremoni të zhvilluar në mjediset e Institucionit të Kreut të Shtetit, Presidentit të Gjykatës Evropiane të Audituesve, z.Vitor Manuel da Silva Caldeira, Titullin "Për Merita të Veçanta Civile": *Për ndihmën dhe kontributin e qenësishëm që ai ka dhënë për përparimin dhe modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.*

Gjatë kësaj ceremonie, Presidenti Nishani pasi i uroi zotit Caldeira mirëseardhjen në Shqipëri edhe në Institucionin e Presidentit të Republikës, theksoi se: "Kontrolli i Lartë i Shtetit po feston sot 90-vjetorin e krijimit të tij dhe personalisht ndihem i privilegjuar që në cilësinë e Presidentit të Republikës jam pjesë e veprimtarive të organizuara me këtë rast, duke vlerësuar së tepërmi edhe institucionalisht rolin që institucioni në përmirësimin e qeverisjes ka dhënë në vijimësi si dhe kontributin e patjetërsueshëm që ka dhënë gjatë këtyre nëntë dekadave.

Ndihem gjithashtu i nderuar që në emër të shtetit, por edhe në emër të institucioneve dhe qytetarëve shqiptarë të vlerësoj zyrtarisht dhe t'i shpreh mirënjohjen zotit Vitor Manuel da Silva Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, duke i akorduar Titullin "Për merita të veçanta civile", për ndihmën dhe kontributin e qenësishëm që ai ka dhënë për përparimin dhe modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit."





Presidenti i Republikës i akordoi gjithashtu në datën 25 maj 2015, Kryetarit të KLSH-së, z.Bujar Leskaj Titullin *"Për Merita të Veçanta Civile" në vlerësim të vizionit të qartë e kontributit të çmuar në ndërmarrjen dhe administrimin e reformave institucionale drejt integrimit evropian, të cilat synojnë shndërrimin dhe konsolidimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në një institucion modern të auditimit të jashtëm publik në të njëjtën linjë me standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t si dhe në përputhje me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.*



Presidenti i Republikës nënvizoi se : ... *"Në këtë 90-vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit edhe në Shqipëri shënon arritje të padiskutueshme në fushën e auditimit. Është një arritje për shkak të kontributeve dhe eksperiencave të brezave të shumtë që punuan dhe shërbyen pranë këtij institucioni shtetëror.*

*Është evident rasti për të nënvizuar se lidershipi i zotit Leskaj në krye të këtij institucioni ka dhënë një dinamizëm mjaft të efektshëm dhe të madh krahasuar me gjithë periudhën e mëparshme. Dëshiroj njëkohësisht sot në këtë përvjetor të shpreh falënderimet dhe vlerësimet edhe për zotin Leskaj në drejtimin e të cilit ky institucion ka arritur standardet më të mira evropiane në Shqipëri.*

*Duke vlerësuar me Titullin për Merita të Veçanta Civile punën dhe kontributin e zotit Leskaj, ne sot vlerësojmë punën e gjithë atyre brezave që me përkushtim, pasion dhe profesionalizëm krijuan një mekanizëm të efektshëm në një linjë me standardet më të përparuara evropiane."*



*(Nga e majta në të djathtë): Z. Naser Ademi, Z. Wojciech Kutyla, Z. Bujar Leskaj, Presidenti Z. Bujar Nishani, Z.Vitor Manuel da Silva, z. Recai Akyel*

Ceremoninë e dekorimit e nderuan me pjesëmarrjen e tyre, z.Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, z.Wojciech Kutyła, Zv.President i NIK-ut Polak; z.Naser Ademi, zv.Auditues i Përgjithshëm i

SAI-t të Maqedonisë dhe pjesëtarë të tjerë të delegacioneve të SAI-ve partnere të pranishme në ceremoninë e 90 vjetorit të Institucionit.

**Presidenti Nishani vlerëson me titullin "Për Merita të Veçanta Civile"**

**z. Josef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i**

**Gjykatës Austriake të Auditimit**

Gjatë ceremonisë së zhvilluar në datën 26 maj 2015 në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë me rastin e 90-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pas përshëndetjes së z. Florjan Nuri, Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës në emër të Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani, u zhvillua një ceremoni protokollare për nder të z.Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Presidentit të Gjykatës Austriake të Audimit.



Zotit Josef Moser, *Për ndihmën dhe kontributin e qenësishëm që ai ka dhënë për përparimin dhe modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,* iu dorëzua në emër të Presidentit të Republikës, Sh. T. Z. Bujar Nishani titulli *"Për Merita të Veçanta Civile"*.

Dr. Josef Moser është Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) që nga viti 2004 dhe ka dhënë ndihmesë të qenësishme për zhvillimet pozitive të kësaj organizate dhe për rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave mes Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI).

Dr. Moser, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës Austriake të Audimit ka mbështetur KLSH dhe ka dhënë ndihmë cilësore dhe këshillime konkrete për modernizimin e institucionit. Nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit mes KLSH-se dhe Gjykatës Austriake të Auditimit në korrik të vitit 2013 institucionalizoi dhe e solli në terma konkretë bashkëpunim mes dy SAI-ve.

## Vizitë në Mini Muzeun e KLSH-së

Në paraditen e datës 27 maj 2015, të ftuarit që morën pjesë në ceremoninë e kremtimit të 90-vjetorit të KLSH-së patën rastin të vizitojnë Mini-Muzeun e KLSH-së.

Të pranishmit u njohën me vlerat e institucionit ndër vite, si dhe me figurat e njohura themeluese dhe drejtuese të këtij institucioni në periudhat e ndryshme të historisë së Shqipërisë. Kjo ekspozitë modeste i shërben ruajtjes së identiteteve të qarta historike të institucioneve kushtetuese dhe rritjes së kujtesës institucionale, forcimit të Shtetit të së drejtës, si dhe kulturës së respektimit të institucioneve tek ne.

Historiania e njohur, Prof. Dr. Kaliopi Naska i njohu të pranishmit me stendat e Mini-Muzeut, ku prezantoheshin me material të bollshëm dokumentar dhe fotografik periudhat kryesore të punës të Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjatë historisë së tij 90 vjeçare, për të ardhur në formën e tij të sotme.

Partnerët e huaj të KLSH vlerësuan dokumentacionin e plotë dhe bënë pyetje të shumta për fazat e ndryshme të zhvillimit të Institucionit dhe për mënyrën e drejtimit dhe funksionimit të tij. Ekspozita pasurohet vit pas viti dhe do të qëndrojë në mënyrë permanente në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.



*Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive, z. Recai Akyel dhe Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Hidajet Bajraktari duke vizituar Mini-Muzeun në ambjentet e Kontrollit të Lartë të Shtetit*



*Z. Vitor Manuel da Silva Caldeira, Kryetar i Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.*



*Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Hidajet Bajraktari, Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive, z. Recai Akyel, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, Koordinatori i Agjencisë Turke për bashkëpunimin dhe koordinim (TIKA) në Tiranë, z. Birol Çetin.*

*Në stendat dhe ambjentet e Mini-Muzeut të KLSH-së qëndron edhe portreti i mikut të KLSH-së z. Recai Akyel, President i Gjykatës Turke të Llogarive. (Foto sipër në të djathtë)*

**Këshilli Bashkiak i Qytetit të Elbasanit, nderon me titullin *"Qytetar Nderi"*, Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive, z. Recai Akyel**

Më 25 Maj 2015, në vigjilje të 90-vjetorit të Kontrolli të Lartë të Shtetit, me vendim të Këshillit Bashkiak të Qytetit të Elbasanit, Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive (TCA), Prof.Ass.Dr.Recai Akyel u nderua me titullin *"Qytetar Nderi"* i Elbasanit për kontributin në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në sallën e teatrit "Skampa", Z. Qazim Sejdini, Kryetari i Bashkisë së Qytetit të Elbasanit, i dorëzoi titullin Presidentit Akyel, duke vlerësuar rolin dhe kontributin e Gjykatës Turke të Llogarive në fushën e auditimit të jashtëm publik në Shqipëri.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak në fjalën e saj, pasi prezantoi karrierën e gjatë të punës së kreut të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, ndër të tjera tha se ky çmim jepet edhe si iniciativë e kreut të KLSH-së së, z. Bujar Leskaj. Motivacioni i titullit për Prof.Ass.Dr. Akyel, shpreh qartë kontributin e Institucionit Suprem të Auditimit të Turqisë në zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të KLSH-së.

Në sajë të impenjimit të lartë dhe vullnetit të dy drejtuesve për bashkëpunim, marrëdhëniet mes dy institucioneve të auditimit, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Turke të Llogarive kanë ardhur duke u forcuar. Në muajin nëntor të vitit 2012, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Turke të Llogarive. Rezultat konkret i marrëveshjes ka qenë kualifikimi i dhjetëra audituesve të KLSH-së në Ankara, të cilët nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Presidentit Akyel, por edhe të një stafi të përkushtuar dhe të lektorëve profesionistë të Gjykatës Turke të Llogarive, janë trajnuar në fushën e Auditimit të

Performancës, të Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Prokurimeve Publike, duke përmirësuar dhe përforcuar ndjeshëm dijet e tyre në këto fusha dhe për rrjedhojë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH në tërësi.

Në fjalën e tij Prof.Ass.Dr. Recai Akyel ka falënderuar Këshillin Bashkiak për akordimin e titullit, si edhe vlerësoi kulturën e qytetit të Elbasanit, duke theksuar se " *....në vitin 2013 Presidenti më nderoi me Medaljen e Mirënjohjes, dhe rektori i Universitetit Politeknik më nderoi me titullin Honoris Causa, dhe ky titull që mora sot në Elbasan më gëzoi jashtë mase. Shpresoj të ndajmë të njëjtat linja, pasi Shqipëria dhe Turqia janë dy popuj vëllezër, për Shqipërinë kemi respekt dhe dashuri, mirëqenia dhe lumturia e Shqipërisë është mirëqënie e përbashkët dhe për popullin turk dhe në sajë të këtyre ndjenjave bashkëpunojmë si institucione me njëri tjetrin. Jam i gatshëm për çdo bashkëpunim në qytetin e Elbasanit në të ardhmen dhe shpresoj se do të vij sërish në këtë qytet".*

Ceremonisë zyrtare iu shtua dhe aktiviteti social me këngë dhe valle nga Ansambli "Isuf Myzyri", një shfaqe origjinale e traditës dhe kulturës qytetare elbasanase, me karakteristikat e mikpritjes së ngrohtë dhe mirënjohjes shqiptare nga ky qytet në zemër të Shqipërisë, për një vend mik si Turqia.



*Kyetari i Bashkisë së Elbasanit Z. Qazim Sejdini nderon me titullin "Qytetar Nderi", Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive, z. Recai Akyel*


SIGAL

**Ceremonia e akordimit të titullit *Qytetar Nderi,* Zv/Kryetarit të NIK-ut Polak, z.Wojciech Kutyla dhe ish-Kryetarit, z. Jacek Jezierski, nga Bashkia Orikum.**




*Kryetari i Bashkisë Orikum z.Gëzim Çapoj nderoi me titullin Qytetar Nderi, Zv. President të NIK-ut, z.Wojciech Kutyla*

Në datën 24 Maj në Qytetin e Orikumit u zhvillua aktiviteti i akordimit të titullit *Qytetar Nderi,* Zv. President të NIK-ut, z.Wojciech Kutyla dhe ish-President të SAI-t Polak, z.Jacek Jezierski, nga z.Gëzim Çapoj, Kryetari i Bashkisë Orikum. Në këtë aktivitet morën pjesë z.Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Këshilli Bashkiak i Orikumit dhe auditues të KLSH-së.

Bashkia Orikum nderoi me titullin *"Qytetar Nderi",* z.Wojciech Kutyla dhe z.Jacek Jezierski, me motivacionin: *"Për kontributin e veçantë në mbështetje të demokracisë*

*dhe ndërtimit të shtetit ligjor duke ofruar bashkëpunimin e pakursyer për rritjen e aftësive profesionale të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Pas akordimit të titullit *"Qytetar Nderi"*, z.Kutyla u shpreh me emocion : *"….Jam shumë i nderuar për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" nga ky qytet shumë i bukur, me histori të gjatë dhe me bijë heronj. Dua t'ju falënderoj për këtë mikpritje në emrin tim dhe të z. Jezierski dhe mendoj se bashkëpunimi midis KLSH-së dhe NIK-ut po rritet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka sjellë efekte të dukshme… "*

Më tej Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, falenderoi Bashkinë Orikum për vlerësimin e dy prej bashkëpunëtorëve më të afërt të KLSH-së në proceset e transformimit të këtij institucioni. Ky vlerësim, u shpreh z.Leskaj, vjen nga një qytet mijëvjeçar, që përfaqëson një krahinë e cila ka vënë vulën në historinë e Shqipërisë. Takimi vazhdoi me evidentimin dhe njohjen e të ftuarve me disa prej fakteve dhe kurioziteteve mbi Poloninë.

Në ceremoni përshëndeti dhe grupi "Jehona Labe" dhe të rinjtë e Orikumit.

*Shënim: Ceremonia e plotë u transmetua nga televizionet lokale të qytetit të Vlorës.*




*Zv. Presidenti i NIK-ut, z.Wojciech Kutyla, Kryetari i Bashkisë Orikum,z.Gëzim Çapoj, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, Specialisti i marrëdhënieve me jashtë në NIK-un Polak, z.Gregorz Haber.*



*Grupi "Jehona Labe", Delegacioni i SAI-t Polak, Kryetari i Bashkisë Orikum dhe Këshilltarët e Bashkisë Orikum.*

*Foto e marrë në ambjentet e jashtme të Bashkisë Orikum, me rastin e akordimit të titullit "Qytetar Nderi" të z. Vojciech Kutyla, Zv/President i SAI-t polak dhe z.Jacek Jezierski, ish-President i SAI-t Polak )*

## Pritja ceremoniale me rastin e 90 vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit

Në datën 25 maj 2015, Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj shtroi një darkë zyrtare në Pallatin e Brigadave për të përshëndetur dhe për t'u uruar mirëseardhjen të gjithë miqve dhe të ftuarve që do të merrnin pjesë në festimet e 90 Vjetorit të institucionit.

Darkën e nderuan me praninë e tyre 120 të ftuar, midis të cilëve z.Vitor Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i SAI-t të Turqisë, z. Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë, z. Milan Dabovic, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z. Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje-Hercegovinës, z. Naser Ademi, Zv. Auditues i Përgjithshëm, SAI i Maqedonisë,z. Wojciech Kutyła, zv. President i NIK-ut të Polonisë, Ambasadorë të akredituar në Shqipëri, përfaqësues të institucioneve të pavarura, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të shoqatave të profesionistëve të fushës së ekonomisë, pedagogë, auditues dhe ish-auditues të KLSH-së, etj.

Kryetari i KLSH-së mbajti fjalën e rastit duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit për prezencën dhe vlerësimin që i kanë bërë kremtimit të 90vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Zoti Leskaj bëri një përmbledhje të historikut të KLSH-së në këto 90 vjet, duke vlerësuar kontributin e të gjithë audituesve gjatë kësaj periudhe të gjatë të funksionimit të institucionit, pavarësisht kushteve në të cilat ka operuar.

Gjatë mbrëmjes, z. Arben Beqiraj, Zv/Kryetar i Bashkisë Vlorë, i dorëzoi titullin "*Qytetar Nderi*" i Bashkisë Vlorë, Prof. Ass. Dr. Recai AKYEL, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, nisur nga aktiviteti i tij i deritanishëm dhe kontributi i veçantë që ka dhënë në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të

modernizimit të këtij institucioni, në mënyrë që auditimi i jashtëm në Shqipëri të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t.

Gjithashtu, Z. Fadil Begu, Kryetar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Peshkopi i akordoi titullin *"Qytetar Nderi"*, Zotit Ivan KLEŠIĆ, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë. Zoti Ivan KLEŠIĆ, në cilësinë e Audituesit të Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, ka dhënë një kontribut të spikatur në promovimin e marrëdhënieve reciproke, të drejtpërdrejta dhe të hapura me KLSH. Bashkëpunimi u konsolidua dhe mori forma konkrete në muajin nëntor të vitit 2012, me nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy institucioneve.

Darka u shoqërua me praninë e një formacioni muzikor të drejtuar nga Dr. Zana Turku, *"Artiste e Merituar"* dhe kaloi në një atmosferë miqësore dhe festive.



*Kryetar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Peshkopi, z.Fadil Begu, i akordoi titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Peshkopi, z. Ivan KLEŠIĆ, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë.*



*Zv/Kryetari i Bashkisë Vlorë, z. Arben Beqiraj i dorëzoi titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Vlorë, Prof. Ass. Dr. Recai AKYEL, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive.*

## Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Lulzim Basha u jep titullin *"Mirënjohje e Qytetit"*, tre personaliteteve të njohura të Auditimit të Jashtëm Publik

Në datën 26 maj 2015, ditën e kremtimit të 90-vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në ambientet e Bashkisë Tiranë u zhvillua ceremonia e dhënies së Titullit "*Mirënjohje e Qytetit*", tre personalitete të njohura të Auditimit të Jashtëm Publik, nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, z.Lulzim Basha, përkatësisht:

Zotit Manuel da SILVA CALDEIRA, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, njërit prej bashkëpunëtorëve të huaj më me kontribute për Kontrollin e Lartë të Shtetit në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve dhe të modernizimit të Institucionit, në mënyrë që auditimi i jashtëm në Shqipëri të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).

Z. Manuel da SILVA CALDEIRA, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës Evropiane të Audituesve, ka dhënë një kontribut të spikatur në promovimin e marrëdhënieve reciproke, të drejtpërdrejta dhe të hapura me KLSH.



*Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Lulzim Basha jep titullin "Mirënjohje e Qytetit" Z. Manuel da SILVA CALDEIRA, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve.*

Zoti Vítor Manuel da SILVA CALDEIRA ka mbështetur trajnimin e disa audituesve të KLSH-së në Gjykatën Evropiane të Audituesve, çka ka ndikuar në përmirësimin dhe përforcimin e dijeve të tyre dhe për rrjedhoje edhe në rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH-së.

Zotit Josef MOSER, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

Zoti Josef MOSER, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës Austriake të Auditimit, ka dhënë një kontribut të veçantë në promovimin e marrëdhënieve reciproke, të drejtpërdrejta dhe të hapura me KLSH. Bashkëpunimi u konsolidua dhe mori forma konkrete në muajin Korrik të vitit 2013, me nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy Institucioneve.



*Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Lulzim Basha jep titullin "Mirënjohje e Qytetit"*
*Z. Josef MOSER, President i Gjykatës Austriake të Auditimit*

Zoti MOSER është emëruar në postin e Presidentit të Gjykatës Austriake të Auditimit në Korrik të vitit 2004.

Roli i z.MOSER ka qenë i rëndësishëm në fushën e zhvillimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, në rritjen dhe intensifikimin e bashkëpunimit midis SAI-ve (Institucion Suprem i Auditimit) me njëra-tjetrën dhe në nxitjen e shkëmbimit të eksperiencave më të mira audituese për zbatimin në praktikë të motos së INTOSAI-t "Experentia mutua omnibus prodest" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve).

Zotit Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, nisur nga kontributi i veçantë që ka dhënë për KLSH-në.

Z. Recai Akyel, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive, ka vlerësuar dhe i ka dhënë përparësi marrëdhënieve me KLSH, të cilat janë të hapura, të drejtpërdrejta, me vlerë të shtuar dhe me përfitime të ndjeshme.

Në sajë të impenjimit të lartë dhe vullnetit të tij për bashkëpunim, kjo marrëdhënie mes dy institucioneve erdhi duke u forcuar dhe u formalizua në muajin nëntor të vitit 2012, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Turke të Llogarive.

Rezultat konkret i Marrëveshjes ka qenë trajnimi i dhjetëra audituesve të KLSH-së në Ankara, të cilët nën përkujdesjen e një stafi të përkushtuar dhe të lektorëve profesionistë të Gjykatës Turke të Llogarive janë trajnuar në fushën e Auditimit të Performancës, të Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Prokurimeve Publike, duke përmirësuar dhe përforcuar ndjeshëm dijet e tyre në këto fusha dhe, për rrjedhojë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH-së në tërësi.



*Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Lulzim Basha jep titullin "Mirënjohje e Qytetit" Z. Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive.*

Në këtë ceremoni morën pjesë Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj, delegacionet e ftuara për të marrë pjesë në kremtimet e 90 vjetorit të institucionit, drejtues dhe auditues të KLSH-së.



*(Nga e majta në të djathtë): Z. Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, Z.Manuel da SILVA CALDEIRA, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, Z.Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë Tiranë, Z.Josef MOSER (i pari djathtas), President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit(INTOSAI).*

**Z. Vítor Manuel da Silva Caldeira nderohet me titullin “Doctor Honoris Causa" nga Universiteti i Tiranës**

Në datën 26 maj 2015 në Sallën e Senatit Akademik të Rektoratit të Universitetit të Tiranës, u organizua ceremonia e dhënies së titullit "Doctor Honoris Causa" z.Vitor Manuel da Silva Caldeira, President i Gjykatës Evropiane te Audituesve, me motivacionin: "*Për kontribut të shquar në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe në nxitjen e marrëdhënieve të drejtpërdreja me institucionet shqiptare për të rritur standardet e auditimit në Shqipëri*".

Zoti da SILVA CALDEIRA, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës Evropiane të Audituesve, ka dhënë një kontribut të spikatur në promovimin e marrëdhënieve reciproke, të drejtpërdrejta dhe të hapura ndërmjet Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe gjithashtu në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të tij. Zoti Caldeira ka mbështetur modernizimin e KLSH-së, në mënyrë që auditimi i jashtëm në Shqipëri të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).



Z. Vitor Manuel da Silva Caldeira ka lindur në Campo Maior, Portugali, në vitin 1960.

Është diplomuar për drejtësi në Universidade Classica në Lisbonë, Portugali. Më pas ka kryer studimet pasuniversiatre në fushën e Studimeve Evropiane në Institutin Europian të Fakultetit Juridik në Lisbonë.

Ka qenë Asistent Profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Lisbonës nga viti 1983 deri më 1984 dhe në Institutin e Lartë të Profesioneve të Reja nga 1996-1999.

Në vitin 1984-2000, ai ka punuar në Inspektoriatin e Përgjithshëm të Financave portugeze.

Nga viti 1995 ka qenë përgjegjës për koordinimin e auditimeve të Komunitetit Evropian dhe sistemit të brendshëm të kontrollit të administrimit financiar të shtetit portugez, duke vijuar më tej si konsulent i OECD në kuadër të iniciativës SIGMA.

Duke qënë pjesë e auditimeve të jashtme në vendin e tij dhe eksperiencave të larmishme në fushën e auditimit, nga marsi i vitit 2000 deri në vitin 2001 i besohet posti i Anëtarit të Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe më pas nga viti 2002 deri më 2006 shërben si përgjegjës për Deklaratën e Gjykatës së Sigurimit dhe Anëtar raportues për opinionin e Gjykatës Nr.2/2004.

Në vitin 2006 deri në vitin 2008, z. Caldeira emërohet Dekan i Grupit CEAD dhe anëtar përgjegjës për Zhvillimin e Auditimit dhe Raporteve.

Në 16 janar 2008 z. Vitor Manuel da Silva Caldeira zgjidhet Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve për një mandat tre vjeçar. Mandati i tij është ripërtërirë në 12 Janar 2011 dhe në 23 Janar 2014.

Në këtë ceremoni morën pjesë Prof. Dr. Dhori Kule, Rektor i Universitetit të Tiranës, senatorët e UT-së, z.Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Genti Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, personalitete nga fusha e ekonomisë, drejtësisë, arsimit, drejtues dhe auditues të KLSH-së dhe shumë të ftuar të tjerë.




*Prof. Dr. Dhori Kule, Rektor i Universitetit të Tiranës, i jep titullin "Doctor Honoris Causa" z.Vitor Manuel da Silva Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve.*




*Z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës se Shqipërisë,z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prof. Dr. Dhori Kule, Rektor i Universitetit të Tiranës, z. Vitor Manuel da Silva Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, ............................., z.Tahir Muhedini, Deputet, Kuvendi i Shqipërisë, ...................................., z. Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive.*

## Vizitë në Galerinë e Arteve

Me rastin e 90-vjetorit të krijimit të institucionit, Kontrolli i Lartë Shtetit organizoi një vizitë në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve.

Në këtë aktivitet morën pjesë, Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z.Vitor Manuel da Silva Caldeira, Sekretari i Përgjithsëm i INTOSAI-t, njëkohësisht dhe Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, Dr.Josef Moser, Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive Prof. As. Dr.Recai Akyel, Zv. Presidenti i NIK-ut të Polonisë, z.Wojciech Kutyła, Audituesi i Përgjithshëm i Kroacisë, z.Ivan Klesic, Presidenti i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z.Milan Dabovic, Presidenti i SAI-të Bosnjë dhe Hercegovinës, z.Milenko Sego, Zv. Audituesi i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë, z.Naser Ademi, Zv. Presidenti i SAI-t të Rumanisë, z.Cosmin Nicula, Zv.Auditues i Përgjithshëm i ZAP-it të Kosovës, z.Artan Venhari, përfaqësues të botës akademike dhe të shoqërisë civile, auditues të KLSH-së, etj.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj, duke ju uruar mirëseardhjen të ftuarve në këtë aktivitet theksoi se trashëgimia kulturore ashtu si edhe trashëgimia institucionale përbëjnë identitetin e një kombi dhe kontribuojnë në konsolidimin, modernizimin dhe ecjen përpara të tij.

Gjatë këtij aktiviteti të ftuarit të shoqëruar nga Drejtori i Galerisë, z.Artan Shabani patën mundësi të njihen me disa nga veprat më të spikatura të piktorëve më të njohur shqiptarë.

Fondi i Galerisë së Arteve ruan vepra në pikturë që datojnë nga fundi i shekullit XIX, periudhë që shënon fillesat e pikturës jo fetare shqiptare. Autori më i hershëm i pikturës është Kol Idromeno, vepra e të cilit "Motra Tone", daton në vitin 1883.

Autorë të tjerë të epokës janë Pjetër Marubi, Simon Rrota, Zef Kolombi, Vangjel Zengo, Spiro Xega etj.

Të ftuarit shprehën interes dhe për të vizituar koleksionin e pikturave të realizmit socialist.

Ky art ishte kryesisht në funksion të propagandës dhe interesave të regjimit politik në vend. Sipas klisheve të gatshme të importuara nga vendet ish komuniste arti fokusohej te punëtorët dhe veprimtaria e tyre, duke i kthyer këta në mite të kohës. Në fakt, realizmi socialist përpiqej të ngrinte një lloj kulti të punës në socializëm dhe kishte *punëtorin* si personazh qendror, i cili personifikonte “epokën e re socialiste”.

Nën shoqërimin e veprave të muzikës popullore, të ftuarit më pas morën pjesë në koktejin e organizuar nga KLSH në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve.



*Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ me Grupin e Audituesve nga Kosova, në ambientet e Galerisë së Arteve*

*Foto nga vizita në Galerinë e Arteve*





**Vizitë në Muzeun Arkeologjik - Durrës**

Në datën 26 maj 2015 në vijim të kremtimeve të përvjetorit të 90-të, të krijimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të gjithë delegacionet pjesëmarrëse ishte organizuar edhe një vizitë në Muzeun Arkeologjik të qytetit të Durrësit.

Në këtë aktivitet morën pjesë Presidenti i Gjykatës Evropiane të Autituesve, z. Vitor Manuel da Silva Caldeira, Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive Prof. As. Dr.Recai Akyel, Zv. Presidenti i NIK-ut të Polonisë, z.Wojciech Kutyła, Presidenti i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z.Milan Daboviç, Presidenti i SAI-t të Bosnje dhe Hercegovinës, z.Milenko Sego, Presidenti i SAI-t të Serbisë, z.Radoslav Sretenovic, dhe përfaqësuesit e Sindikatës së audituesve nga ZAP i Kosovës, si dhe delegacionet shoqëruese.

Nga të gjithë të pranishmit u ndoq me mjaft interes guida e organizuar në pavionet e Muzeut Arkeologjik. Interes i veçantë u shpreh mbi periudhën ilire dhe greke të hershme në të tre fazat e saj, në atë klasike dhe të vonë, apo siç quhet aleksandrike.

Gjithashtu, vëmendje tërhoqi edhe periudha romake, nga ajo e hershme e deri në periudhën e ndërtimeve më të vona.

Muzeu Arkeologjik i Durrësit përmban një fond prej 3204 objektesh, nga të cilat 2400 janë ekspozuar së fundi dhe pjesa tjetër do të vijojë të ekspozohet në vijim.

*Foto gjatë Vizitës në Muzeun Arkeologjik - Durrës*





**Darkë zyrtare në vilën 31, me rastin e 90 vjetorit të KLSH-së**

Me rastin e 90-vjetorit të themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetari i KLSH-së, zoti Bujar Leskaj, shtroi një darkë zyrtare për nder të të ftuarve në këtë përvjetor.

Në darkën e organizuar në Vilën 31 në kryeqytet, ishin të pranishëm personalitete të larta të Institucioneve Supreme të Auditimit nga rajoni dhe nga Europa: z.Vitor Caldeira, President i ECA; z.Recai Akyel, President i SAI-t Turk; z.Ivan Klesic, President i SAI-t të Kroacisë; z.Milan Dabovic, President i Senatit të SAI-t i Malit të Zi; z.Milenko Sego, President i SAI-t të Bosnje-Hercergovinës, z.Wojciech Kutyła, Zv/President i NIK-ut të Polonisë; z.Radoslav Sretenovic, President i SAI-t të Serbisë, z.Fiqiri Kllari, Konsull i Bosnjës dhe Hercegovinës si edhe deputetë, përfaqësues të OJF-ve, të profesionistëve të fushës së Ekonomisë dhe Auditimit, etj.

Në këtë aktivitetet kushtuar 90 vjetorit të themelimit të KLSH-së morën pjesë edhe ish- kryetarë që e kanë drejtuar këtë institucion në vite.

Gjatë darkës, Ansambli “Çipini” performoi me disa këngë polifonike të jugut të Shqipërisë, duke shpalosur për të ftuarit edhe këtë pasuri kulturore që mbart vendi ynë, siç është polifonia labe.

Në këtë darkë pati edhe një surprizë të bukur për z.Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilit iu dha titulli “*Qytetar Nderi*” i Bashkisë Shijak nga z.Indrit Buka, Kryetar i Bashkisë Shijak.

Në korrik të vitit 2013, Kontrollit i Lartë i Shtetit dhe Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës, nënshkruan në Sarajevë një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve. Kjo marrëveshje u nënshkrua edhe falë dëshirës dhe vendosmërisë për bashkëpunim të Audituesit të Përgjithshëm

të kësaj Zyre, z.Milenko Sego, i cili ka vlerësuar bashkëpunim me KLSH-në si mjaft pozitiv dhe frytdhënës, duke vlerësuar shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe njohurive ndërmjet palëve, nën moton e INTOSAI-t, “Eksperienca e përbashkët ju shërben të gjithëve”, por edhe në kuadrin e një bashkëpunimi më të ngushtë rajonal për të dy vendet, Shqipërinë dhe Bosnje- Hercegovinën. Rezultatet e marrëveshjes së bashkëpunimit kanë qenë konkrete në fushën e trajnimeve dhe të auditimeve të përbashkëta, veçanërisht në fushën e auditimit të Performancës, por edhe për çështje të tjera me interes për të dy palët.

Të pranishmit e falënderuan zotin Leskaj për mikpritjen dhe shprehën kënaqësinë të vizitojnë sërish Shqipërinë. Darka kaloi në një atmosferë miqësore dhe festive.



*Z. Fiqiri Kllari, Konsull Nderi i Bosnje dhe Hercegovinës, z. Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës, z.Indrit Buka, Kryetar i Bashkisë Shijak, Z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së.*

*Foto gjatë Darkës zyrtare në vilën 31, me rastin e 90 vjetorit të KLSH-së*






Z. Stefan PAPAGJONI
Ish- KRYETAR i KLSH

**Zoti Ivan Klesiç, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t Kroat dhe z. Milan Daboviç, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi u nderuan me titullin "*Qytetar Nderi*" të Qarkut të Shkodrës**

Në datën 27 maj në qytetin e Shkodrës u nderuan me titullin "*Qytetar Nderi*" të Qarkut të Shkodrës, dy personalitete të larta të fushës së auditimit z. Ivan Klesiç, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t Kroat dhe z. Milan Daboviç, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi. Pjesëmarrës në këtë aktivitet të zhvilluar në Teatrin Migjeni të Shkodrës, ishin z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Maxhit Cungu, Kryetar i Këshillit të Qarkut të Shkodrës, z.Lorenc Luka, Kryetari i Bashkisë Shkodër, si dhe auditues të KLSH-së.



*(Nga e majta në të djathtë): z.Lorenc Luka, Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Maxhit Cungu, Kryetar i Këshillit të Qarkut të Shkodrës, z. Milan Daboviç, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z. Ivan Klesiç, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t Kroat, z.Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit*

Këshilli i Qarkut të Shkodrës u akordoi titullin "*Qytetar Nderi*" të Qarkut Shkodër, z. Daboviç dhe z. Klesiç, me motivacion kontributin e tyre në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Zoti Ivan Klesiç, në cilësinë e Audituesit të Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, ka dhënë një kontribut të spikatur në promovimin e marrëdhënieve reciproke, të drejtpërdrejta dhe të hapura me KLSH. Bashkëpunimi u konsolidua dhe mori forma konkrete në muajin nëntor të vitit 2012, me nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy Institucioneve. Zoti Klesiç ka një eksperiencë të gjerë pune në fusha të ndryshme dhe ka dhënë kontributin e tij në Administratën Publike në institucione të rëndësishme publike, si në Ministrinë e Brendshme ku ai i ka kryer detyrën e Drejtorit të Departamentit, përgjegjës për aktivitetin financiar, kontabël dhe burimet njerëzore.

Në korrik të vitit 2013, në Podgoricë, KLSH nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionin Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi dhe roli i z.Milan Dabovic, si President i Senatit të këtij institucioni, ka qenë parësor. Zoti Daboviç ka vlerësuar bashkëpunim me KLSH-në si mjaft pozitiv dhe frytdhënës, duke vlerësuar shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe njohurive ndërmjet palëve nën moton e INTOSAI-t, "Eksperienca e përbashkët ju shërben të gjithëve", por edhe në kuadrin e një bashkëpunimi më të ngushtë rajonal për dy vende fqinje, si Shqipëria dhe Mali i Zi. Rezultatet e marrëveshjes së bashkëpunimit kanë qenë konkrete në fushën e trajnimeve dhe të auditimeve të përbashkëta që trajtojnë çështje me interes të ndërsjellë.

Përfaqësuesit e Institucioneve Supreme homologe të Auditimit, u shprehën të nderuar për marrjen e këtij titulli dhe theksuan bashkëpunimin e mëtejshëm me KLSH-në edhe në nivel lokal me Qarkun e Shkodrës.

Ky event, u organizua në vazhdën e aktiviteteve për 90-vjetorin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

*Në përfundim, pjesëmarrësit u përshëndetën nga grupe muzikore të Teatrit Migjeni.*



*Z. Lorenc Luka, Kryetari i Bashkisë Shkodër i akordon titullin "Qytetar Nderi" i Qarkut Shkodër z. Milan Daboviç, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi.*



*Z. Maxhit Cungu, Kryetar i Këshillit të Qarkut Shkodër, i akordon titullin "Qytetar Nderi" i Qarkut Shkodër, z. Ivan Klesiç, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t Kroat.*

## *III. Pasqyrimi në media i 90 vjetorit të KLSH-së*

*Kremtimi i 90-vjetorit të KLSH-së u pasqyrua gjerësisht nga të gjitha mediat e shkruara, vizive, portalet e ndryshme dhe faqet online.*

*Gjejmë rastin të falënderojmë të gjithë gazetarët që ndoqën eventin dhe të gjitha Mediat për pasqyrim e ceremonisë së 90-vjetorit të KLSH-së.*

**Top Channel**
90 vjet nga krijimi i KLSH-së, Meta dhe Leskaj vlerësojnë reformimin.

**TV Klan**
90 –vjetori i KLSH, Leskaj: Luftë pa kompromis korrupsionit.

**Vizion Plus**
90 vjetori i krijimit të KLSH-së.

**ABC**
90 vjetori i KLSH, Meta: Sfida e mazhorancave shmangia nga ndikimi politik. Legjislativi garanton pavarësi financiare.

**News 24**
KLSH kremton 90 vjetorin.

**Ora News**
90 vjetori i KLSH, Leskaj: Synojmë një trupë akoma më profesionale audituesish.

**SCAN TV**
Leskaj: Të vendosur për forcimin e pavarësisë .
http://scan-tv.com/v/index.php/lajme/nga-vendi/13307.html

Dokumentari mbi 90 vjetorin e KLSH.

**RTSH**

Kremtohet në ambjentet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë 90 vjetori i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Channel one**
90-vjetori i KLSH. Ceremoni në Kuvend, vlerësime për institucionin.
